



**FRIEDRICH NAUMANN
FOUNDATION** For Freedom.

Western Balkans



freiheit.org

KOSOVA - QYTETET E MENÇURA TANI DHE E ARDHMJA

Për botuesin

Autori



Redaktoi

Michael Roick & Dr. Minire Çitaku

Dizajni dhe Printi

KATËR AGENCY

Numri i kopjeve

100

Përkthimi:

Lumni Rama

Botuesi

Friedrich Naumann Foundation for Freedom
Western Balkans
Bulevar kneza Aleksandra Karadjordjevica 13/A8,
11000 Belgrade, Serbia
00 381 11 3066824
www.freiheit.org
www.freiheit.org/western-balkans
westbalkan@freiheit.org

 @FNFWesternBalkans

 @FNFWestbalkans

Copyright Dhjetor 2021.

nga Fondacioni Friedrich Naumann për Liri.

Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Ky artikull pasqyron mendimin e autorit dhe jo domosdoshmërisht pozicionin e Fondacionit Friedrich Naumann për Liri!

Qëllimi i këtij studimi ishte identifikimi i mjeteve të qyteteve të mençura që tashmë janë në zbatim apo që janë planifikuar dhe inovacionet e tilla në njësitet e qeverisë lokale në Kosovë (QLK); vështirësitë me të cilat ballafaqohen komunitat gjatë zbatimit të tyre; potenciali për rrjetëzim ndërmjet institucioneve lokale dhe atyre qendrore mundësit teknologjike të qyteteve të mençura pas pandemisë COVID 19; si dhe pjesëmarrja e qytetarëve në transformimin e qyteteve të mençura. Ky studim është mbështetur nga Fondacioni Friedrich Nauman për Liri.

Parafjalë

Që nga viti 2013, Fondacioni Friedrich Nauman për Liri ka rritur përkushtimin për fushën tematike "Qyteti i Mençur" (Smart City), posaçërisht në nivelin lokal.

Në fokus kanë qenë konceptet dhe zgjidhjet inventive të IT-së që mund të përmirësojnë ndjeshëm kualitetin e jetës së qytetarëve, jo vetëm në zona urbane por posaçërisht atyre në zona rurale.

Koncepti "Qyteti i Mençur" duhet të kuptohet si proces e jo si qëllim.

Tutje, Fondacioni mëton qëllimisht një qasje regjionale, në të cilën vlerat empirike komunikohen, diskutohen dhe zbatohen praktikisht brenda kornizës së iniciativës përmes masave arsimore, rrjetizimit ndërkufitar dhe masave të dialogut evropian.

Pra, ky studim hartografik i paraqitur këtu, nuk është një masë e vetme. Në dispozicion ka po ashtu, edhe studime krahasuese për Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Serbi dhe siç po shihet këtu, këmbimi i përvojave ka një rëndësi të jashtëzakonshme.

Së pari, ky studim hartografik është një inventar i inovacioneve dhe mjeteve që tashmë janë duke u zbatuar ose janë të planifikuara në njësitet e qeverisjes lokale në Kosovë. Si pjesë shtesë, ky studim ofron të dhëna deri në cilën masë zgjidhjet e qyteti i mençur kanë marr vëmendjen më të madhe për shkak të pandemisë COVID 19 dhe një shtytje më të madhe për përdorimin e tyre.

Qasja metodologjike e punës me pyetësor të testuar më parë dhe intervistat specifike me vendim-marrësit komunal ose partnerët e tyre në nivelin qendror (grupe fokusi), janë të besueshme, siç është edhe diksioni dhe stili. Të gjitha këto e bëjnë temën të kapshme madje edhe për ata që janë të interesuar e që nuk janë ekspert të këtyre çështjeve.

Për shkak të numrit relativisht të vogël të komunave pjesëmarrëse, sigurisht që nuk mund të duket gjithëpërfshirës, mirëpo, si një "hulumtim kualitativ", ky studim ofron informata të rëndësishme për aktorët politik dhe të shoqërisë civile, si një bazë dhe udhërrëfyes për vendimet në të ardhmen.

Michael Roick

Drejtor i Zyrës për Ballkanin Perëndimor
Fondacioni Friedrich Naumann për Liri

Përmbajtja

1. Përmbledhje	5	4.7.3 Bashkëpunimi ndërmjet kompanive dhe sektorit publik.Për fund, qytetet e mençura kanë ofruar një mundësi për sektorin privat dhe kompanitë tjera që të bashkëpunojnë me institucionet qeveritare, për tu marr me sfidat urbane si trafiku, ndotja e ajrit, kualiteti i ujit dhe mbeturinat. Me krijimin e infrastrukturës nga qeveria dhe duke ju ofruar të dhëna kompanive, kompanitë mund të përqendrohen krijimin e zgjidhjeve që janë në të mirë të qytetarëve. Bashkëthemeluesi dhe drejtori i Kode Labs, një kompani me përvojë në qytete të mençura nga Detroiti, Mishigan, theksoi se bashkëpunimi ndërmjet kompanive dhe institucioneve është krucial, për ndërtimin e qyteteve të mençura.	52
1.1 Të gjeturat kryesore	6		
2. Hyrje	8		
3. Metodologjia	10		
3.1 Hulumtimi kuantitativ	10		
3.2 Hulumtimi kualitativ	12		
4. Rezultatet	18		
4.1 Profili demografik i njësive të QL-ve.	18	5. Rekomandime për iniciativat qyteti i mençur në të ardhmen në Kosovë	59
4.2 Familjariteti/njohuritë me konceptin qyteti i mençur	19	5.1 Ofrimi i mbështetjes për qeveritë lokale	59
4.3 Iniciativat e planifikuara dhe të ndërmarra për të arritur objektivat drejt Qytetit të Mençur	23	5.2 Fuqizimi i bashkëpunimit ndër komunal	60
4.3.1 Administrata	26	5.3 Caktimi i udhëheqësit në nivelin komunal dhe atë kombëtar	60
4.3.2 Shërbimet publike në emër të brengave	28	5.4 Zhvillimi i vizionit dhe strategjive kombëtare qyteti i mençur	61
4.3.3 Planifikimi urban dhe mobiliteti	30	5.5 Transformimi digjital i shërbimeve publike	61
4.3.4 Energjia	34	5.6 Inkurajimi i hisedarëve të përfshirë të përdorin open data	62
4.3.5 TIK-u dhe Open Data	37	5.7 Arsimi dhe trajnimi i shoqërisë civile	63
4.5 Kufizimet dhe sfidat	43		
4.7 Bashkëpunimi ndërmjet hisedarëve	49		
4.7.1 Bashkëpunimi ndër komunal	50		

Lista e figurave

Figura 1: Madhësia e komunës

Figura 2: Si e vlerësoni nivelin e njohurive të zyrtarëve komunal me nocionin "Qyteti i Mençur"? vlerësoni nga 1 deri nderi në 5, ku 1 = s'ka njohuri fare dhe 5 = e njeh plotësisht konceptin

Figura 3: Cila deklaratë e përshkruan më së miri konceptin Qyteti i Mençur në komunën tuaj?

Figura 4: Si keni marr vesh për konceptin dhe iniciativat "Qyteti i Mençur"?

Figura 5: Në angazhimin për tu bërë Qyteti Mençur, sa mendoni se është e rëndësishme që të arrihet kjo?

Figura 6: A ka zbatuar ndonjë projekt të "Qytetit të Mençur" komuna e juaj në njëren nga fushat në vijim?:

Figura 7: Përmbledhje e iniciative të planifikuara dhe të zbatuara në komunat e Kosovës, të ndara sipas sektorëve

Figura 8: A ndan zakonisht qeveria e juaj lokale një shumë të caktuar për financimin e teknologjive të qytetit të mençur (senzora, monitorim dhe sofver parashikues, etj.) gjatë planifikimit të projekteve për infrastrukturë fizike (transporti, uji, energjia, teknologji të komunikimit, etj.)?

Figura 9: Nëse po, cila është përqindja e buxhetit të projektit që ndahet për teknologjitë e "Qytetit të Mençur"?

Figura 10: Cilat ishin burimet e financimit të projekteve "Qytetit i Mençur" që janë zbatuar në komunën tuaj?

Figura 11: Cilat nga pengesat e mëposhtme paraqesin barriera për zbatimin e teknologjive "Qyteti i Mençur" në komunën tuaj?

Figura 12: Në mesin e komponentëve të konceptit "Qyteti i Mençur", cilat duken më së lehti të zbatueshme në qytetin tuaj?

Figura 13: Si e vlerësoni përkushtimin e përgjithshëm të komunës tuaj në zbatimin e iniciativave "Qyteti i Mençur"?

Figura 14: Për secilin sektor në vijim, çfarë niveli të prioritetit paraqesin teknologjitë Qytei i Mençur për komunën tuaj?

Figura 15: A mendoni se tekonologjitë Qyteti i Mençur ishin të nevojshme derisa duhej të merreni me pandeminë COVID 19? [Me teknologji Qyteti i Mençur mendojmë zgjidhjet në fushat e ndryshme si transporti, infrastruktura, shërbimet publike, mjekësi, arsim etj.]

Figura 16: A është rritur vlera e përdorimit të zgjidhjeve të mençura që nga përhapja e pandemisë COVID-19?

Figura 17: A keni ndërmarrë ndonjë iniciativë nga koncepti "Qyteti i Mençur" që nga përhapja e pandemisë COVID-19?

Lista e shkurtesave

ASHI	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
OB	Organizatrat buxhetore
PNSI	Plani ndër-sektorial i intervenimit
PDPP	Platforma digjitale për pjesëmarrje publike
TIK	Teknologjia e informatike dhe komunikimit
GS	Gazrat serë
AKEE	Agjencia e Kosovës për efikasitet në energji
EDK	Ekonomia digjitale e Kosovës
QL	Qeverisja lokale
MEM	Ministria e Ekonomisë dhe Mjedisit
NAMA	Inicimi i veprimit urban kombëtarë të zvogëlimit të gazrave serë
ODK	Open Data Kosova
PGGC	Qendra për zhvillim të gjelbër në Prizren

1. Përmbledhje

Koncepti Qyteti i Mençur përdoret për të përcaktuar një vend që përdor me efikasitet burimet që i ka në dispozicion, përmes përdorimit të inovacioneve dhe teknologjive, duke siguruar pjesëmarrjen e qytetarëve përmes pjesëmarrjes online dhe e-qeverisjen për të adresuar çështje dhe për të përmirësuar kualitetin e jetës së qytetarëve.

Ky studim ka për qëllim të vlerësoj nivelin e njohurive të njësive të qeverisjes lokale (QL) në Kosovë për konceptin e qyteti i mençur dhe për të identifikuar iniciativat qyteti i mençur të planifikuara dhe të zbatuara në Kosovë, vështirësitë me të cilat ballafaqohen komunat në zbatim, potenciali për rrjetëzim ndërmjet komunave dhe nivelit qendrorë, mundësit për qytete të mençura pas pandemisë COVID 19 si dhe për pjesëmarrjen e qytetarëve në transformim përmes qyteteve të mençura. Ky studim është mbështetur nga Fondacioni Friedrich Nauman për Liri.

Për qëllime të këtij studimi, janë organizuar: një pyetësor i bazuar në internet me komunat e Kosovës, intervista gjysmë të strukturuar me pjesëmarrësit e pyetësorit të bazuar në internet dhe pesë (5) grupe fokus. Pyetësorët e bazuar në internet dhe intervistat gjysmë të strukturuar ishin drejtuar zyra të kryetarëve të komunave ndërkaq, diskutimet në grupet e fokusit u mbajtën me drejtorët komunal të sektorit të administratës, shërbimeve publike, planifikimit urban, energji dhe teknologji informatike dhe të komunikimit (ITK) dhe Open Data, me zyrtarë të institucioneve të qeverisë qendrore, me përfaqësuesit e kompanive dhe organizatave joqeveritare.

1.1 Të gjeturat kryesore

- Fillimisht, kur është kërkuar nga ata për të vlerësuar shkallën e njohurive të tyre për konceptin e Qytetit të Mençur prej shkallës 1 (aspak njohuri) deri në 5 (njohuri të plotë), më shumë se gjysma e të anketuarve 56.14% kanë thënë se kanë njohuri deri në një masë/mesatarisht për konceptin. Niveli mesatar i njohurive të anketuarve ishte 2.928.
- Pesë deklaratat kryesore që u identifikuan për të përshkruar iniciativat Qyteti i Mençur nga komunat janë: kontributi për realizimin e një vizioni gjithëpërfshirës për zhvillimin e qytetit (16.9%), digjitalizimi i qyteti (15.3%), përmirësimi i jetës së qytetarëve (13.6%) pjesëmarrje aktive e qytetarëve në zhvillimin ekonomik (10.2%) dhe kontributi në një zhvillim të qëndrueshëm (8.5%).
- Të dhënat shpalojnë se rrjetet sociale janë burimi primar i informatave për konceptet dhe iniciativat e Qytetit të Mençur (30%) pasuar nga ngjarjet/konferencat (17.5%).
- 78.6% të përfaqësuesve komunal, pjesëmarrjen në konferenca e konsiderojnë si gjë me rëndësi të madhe gjatë kohës që janë duke punuar në projekte të Qytetit të Mençur, pasuar nga këmbimi i përvojave më të mira (64.3%) dhe vlerësimin e procesit të shndërrimit në qytet të mençur (64.3%).
- Më shumë se gjysma e përfaqësuesve komunal nga pyetësi (65%) kanë thënë se nuk kanë ndërmarr iniciativat qyteti i mençur në asnjërën nga 12 fushat/sectorët e dhënë.
- Në përgjithësi, iniciativat e planifikuara dhe të zbatuara përfshijnë: transformimin digjital të shërbimeve publike, pjesëmarrjen e qytetarëve përmes platformave elektronike, hapja e të dhënave për përdorim nga publiku, inkurajimi për përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, ofrimi i infrastrukturës për llojet e mobilitetit, etj.
- Shumica e përfaqësuesve të komunave (71.43%) kanë deklaruar se ndajnë një shumë të caktuar fondesh për iniciativat qyteti i mençur.
- Tutje, gjysma e komunave pjesëmarrëse kanë pohuar se ndajnë 1-5% të buxhetit të tyre për mjete të qytetit të mençur dhe 25% prej tyre ndajnë 5-10% të shpenzimeve të tyre.
- Fondet publike nga qeveritë lokale dhe ajo qendrore (50%) dhe fondet nga organizatat donatore ndërkombëtare (43.86%) janë identifikuar si burim kryesor i financimit të projekteve qyteti i mençur.
- Sfida kryesore për zbatimin e projekteve qyteti i mençur, është identifikuar nga të anketuarit të jenë kufizimet buxhetore 927.1%). Vështirësitë e tjera të identifikuar janë: mungesa e ekspertizës teknike (12.5%), mungesa e infrastrukturës mbështetëse (10.4%), mungesa e kapaciteteve të brendshme (6.3%), etj.
- Gjatë shënimit të komponentëve më të lehta për zbatim të qytetit të mençur, përgjigjet e të anketuarve ndryshojnë. 31.% shënuan qeverisjen e mençur si më e lehtë, 20% mjedisin e mençur dhe pjesa tjetër ishin të ndarë në mes mobilitetit të mençur dhe ekonomisë së mençur.

- Më shumë se gjysma e përfaqësuesve komunal (57.14%) e konsiderojnë përkushtimin e tyre për iniciativave qyteti i mençur, të jenë prioritet i lartë, ndërsaq për 14.15% prej tyre kjo nuk është prioritet fare.
- Të dhënat shpalojnë se iniciativat qyteti i mençur konsiderohen si prioritet numër një në shëndetësi, arsim dhe shërbime njerëzore, përkujdes për konsumatorët dhe angazhimin publik nga shumica e të anketuarve (57%). Sektorët tjerë ku iniciativat qyteti i mençur janë prioritet kryesor, sipas përgjigjeve të anketuarve janë: siguria publike (35.7%), ndotja e ajrit dhe mbrojtja e mjedisit (35.7%), energjia (35.7%), pagesat elektronike dhe financat e mençura (35.7%) dhe Open Data (35.7%).
- Në përgjithësi, ka një mungesë të bashkëpunimit ndër-komunal në këmbimin e përvojave dhe mësimave të zëna për iniciativat qyteti i mençur, ndërsa, ka një bashkëpunim ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal në sektorët e TIK-ut dhe energjisë. Sektorët e planifikimit urban dhe shërbimeve publike kanë theksuar se ka një mungesë të një bashkëpunimi të tillë dhe kanë pohuar se kjo është njëra nga sfidat kryesore për transformimin e Qytetit të Mençur.
- Më shumë se gjysma (71.4%) e përfaqësuesve të komunave deklaruan se vlera e zgjidhjeve qyteti i mençur është rritur pas përhapjes së pandemisë COVID 19.
- 64.29% e komunave pjesëmarrëse në studim pohuan se kanë ndërmarr projekte qyteti i mençur që nga përhapja e pandemisë. Në përgjithësi, iniciativat përfshinin digjitalizimin e shërbimeve për qytetarët, krijimi i platformave për mësim online, krijimi i platformave për aplikacione për ndihmë financiare, etj.
- Shumica e drejtorëve të komunave konfirmuan se kanë vërejtur një ndryshim të sjelljes në mobilitet, që nga përhapja e pandemisë COVID 19, duke rezultuar në ngritje të numrit të çiklistëve dhe këmbësorëve dhe zvogëlimin e numrit të veturave në trafik.
- Burimi kryesor për informim dhe ngritje të vetëdijes tek qytetarët për iniciativat e reja dhe për përfitimet që dalin nga to, janë rrjetet sociale.

2. Hyrje

Më shumë se gjysma e popullatës botërore sot jeton në zona urbane. Ky trend pritet të rritet deri në 66% deri në vitin 2050. Në kohën kur zonat urbane po zgjerohen në mënyrë eksponenciale, njëra nga sfidat më të rëndësishme është krijimi i kapaciteteve të qeverisjeve lokale për menaxhuar nevojën në rritje për shërbime publike. Krijimi i zgjidhjeve dhe qasjeve kreative për një përdorim më efektiv të burimeve të kufizuara në një mjedis që vazhdimisht ndryshon, është duke u bërë një gjë esenciale. Prandaj, përveç sfidave, rritja e trendit të urbanizimit, ka ofruar edhe një mundësi për transformimin e qyteteve në vende të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, ku informatat dhe reagimet e qytetarëve përmes e-qeverisjes dhe e- pjesëmarrjes, përdoret për të përmirësuar jetën urbane. Këto vende ku inovacioni dhe teknologjia përdoren për përdorimin efikas dhe të qëndrueshëm të burimeve, quhen qytete të mençura. Mjetet e mençura dhe inovacioni po e bëjnë të mundur transformimin e komuniteteve tona drejt vendeve të mençura, të ndërlidhura, të pastra, të sigurta, të rehatshme dhe me një efikasitet të lartë të energjisë për të jetuar.

Kosova i është bashkuar iniciativës të Qyteteve të Mençura me qëllim të integritetit të zgjidhjeve efikase dhe inventive, që do të u shërbejnë nevojave që dalin nga rritja e popullatës urbane në afat të gjatë. Krijimi i një shoqërie digjitale të së ardhmes, d.m.th. komunitet të mençur dhe të sigurt, është njëri nga objektivat e qeverisë së Kosovës. Po ashtu, ky objektiv, mbështetet në rregullat kombëtare që mëtojnë të sigurojnë një përmirësim sistematik të kapaciteteve inventive të qyteteve dhe komunave. Aktivitetet e ndërmarra nga institucionet e Kosovës, mbulojnë një gamë gjerë

fushash si financa, banka, shërbime publike, mobilitet të qëndrueshëm, planifikim urban dhe energji të qëndrueshme. Deri sa Kosova është duke punuar në agjendën e saj të Qytetit të Mençur, ajo e ka përparësinë të shohë se si këto gjëra kanë funksionuar në vendet tjera dhe si qeveritë e vendeve tjera i kanë adresuar problemet e ngjashme.

Pandemia COVID 19 ka qenë katalizator i proceseve të transformimit digjital në zonat urbane. Duke qenë se siguria ishte njëra nga brengat kryesore, institucioneve ju desh që të bëjnë prioritet në agjendën e tyre transformimin digjital të administratave të tyre. Kemi qenë dëshmitar të një ndërrimi të sjelljes në mobilitet, që nga mbyllja në marsin e vitit 2020, kemi përjetuar një ulje domethënëse në përdorimin e veturave për të lëvizur, gjë që qoi në rritjen e numrit të këmbësorëve dhe çiklistëve. Kosova duhet të shohë mundësitë pas pandemisë COVID 19 për kualitetin e jetës dhe ndërrimin e modelit të jetës në qytete të Kosovës, duke mësuar nga përvojat e mbylljes, d.m.th të mësojmë për ndryshimin e mënyrës si e shohim shëndetin publik, sigurinë, transportin dhe sjelljen tonë në përgjithësi.

Transformimit të zonave ekzistuese urbane në vende të mençura dhe të qëndrueshme në Kosovë, për momentin i mungon një vizion dhe strategji që nxitë përparim. Ky studim në mesin e gjërave tjera, mëton që të identifikoj iniciativat, kufizimet dhe mundësitë për përparim në këtë drejtim. Rezultatet e këtij studimi do të i paraqiten të gjitha institucioneve relevante dhe hisedarëve dhe do të shërbejnë si udhëzime për ta për dizajn të programeve, aktiviteteve ose formave të intervenimit të tyre, drejt mbështetjes së komunave të Kosovës në transformimin e zonave të tyre urbane, me zgjidhje të mençura.

Ky studim është dizajnuar për të gjetur:

- Njohuritë e zyrtarëve publik për konceptin qyteti i mençur,
- Iniciativat Qyteti i Mençur, të planifikuara dhe tashmë të zbatuara,
- Financimin e iniciativave qyteti i mençur
- Kufizimet dhe sfidat në zbatimin e iniciativave qyteti i mençur
- Bërja prioritet i iniciativave qyteti i mençur në agjendën komunave,
- Bashkëpunimi ndërmjet hisedarëve të ndryshëm që janë pjesë e ekosistemit qyteti i mençur,
- Ndikimi i pandemisë COVID 19 në planifikimin e Qytetit të Mençur,
- Pjesëmarrjen e qytetarëve.

Ky studim është porositur nga Fondacioni Friedrich Nauman për Liri dhe është zbatuar nga agjencia UBO Consulting dhe në vete përmban detyrat në vijim:

- Hartimin e një përmbledhje të politikave të iniciativave për Qytetet e Mençura në Kosovë,
- Propozimin për metodën e mbledhjes së të dhënave dhe procedurat,
- Bërja e intervistave gjysmë të strukturuar online me njësi të qeverisjes lokale,
- Bërja e diskutimeve në grupe fokusi me drejtorë komunal, zyrtarë të institucioneve qeveritare dhe me përfaqësuesit e kompanive dhe organizatave joqeveritare nga pesë (5) sektor të ndryshëm (administrata, shërbimet publike, planifikimi urban, energjia, teknologjia e informimit dhe komunikimit (TIK) dhe Open Data),
- Bërjen e analizës së të dhënave ,
- Hartimi i publikimit nga pjesët kuantitative dhe kualitative të studimit.

Ky dokument është hartuar për të paraqitur rezultatet që dalin nga pyetësorët online, nga intervistat gjysmë të strukturuar dhe nga pesë (5) diskutime në grupe fokusi. Tutje, ky dokument përfshinë, qasjen metodologjike dhe procesin e instrumenteve dhe të rekrutimit. Po ashtu, pjesë të këtij raporti janë edhe përfundimet dhe rekomandimet.

3. Metodologjia

Për qëllime të këtij studimi, UBO Consulting ka përdorur të dy metodat, atë kuantitative dhe atë kualitative të hulumtimit, për të identifikuar mjetet dhe inovacionet e Qytetit të Mençur që tashmë janë zbatuar, paralelisht me projektet Qyteti i Mençur, të cilët ose tashmë janë zbatuar, iniciuar, ose thjesht janë planifikuar në njësitet e qeverisjes lokale në Kosovë.

Në fazën e parë të këtij studimi, UBO Consulting ka përdorur metodën kuantitative të hulumtimit, për të vlerësuar perceptimin e njësive të QL për iniciativat qyteti i mençur, identifikimin e mjeteve apo inovacioneve tashmë të planifikuara ose të zbatuara dhe vlerësimin e sfidave me të cilat komunat ballafaqohen gjatë zbatimit. Pyetësi ishte i përbërë nga 24 pyetje, 5 prej të cilave kishin të bëjnë me demografinë. Pyetësi kishte pyetje të dizajnuara për të bërë vlerësimin e njohurive të përfaqësuesve të njësive të QL-ve për temat, aktivitetet e ndërmarra nga komunat e tyre, kufizimet dhe sfidat, si dhe financimin e këtyre iniciativave. Si pjesë shtesë, janë dhënë përshkrime për konceptet që të anketuarit, potencialisht nuk kanë qentë të njohur me to. Kjo është bërë për të ua bërë atyre më të qartë kuptimin e koncepteve.

3.1 Hulumtimi kuantitativ

Njëri nga hapat më të rëndësishëm të studimit është dizajni i mostrës, pasi që kjo siguron saktësinë e informatave të studimit. Në këtë drejtim, mostra duhet të reflektoj qëllimin kryesor të studimit, brenda kornizës së parimeve shkencore dhe mundësive që ato ofrojnë. Duke marr parasysh qëllimin e këtij studimi, mostra për sondazh online përbëhej nga përfaqësuesit e secilës QL. Ftesa për të qenë pjesë e këtij studimi i është dërguar zyryave të kryetarëve të 34 komunave, të dy komuniteteve, atij shqiptar dhe atij serb. Ftesa për të plotësuar sondazhin u është dërguar përmes email-it, pasur nga një telefonatë me personat. Email-at përmbanin tekstin për qëllimin e studimit, bashkangjitur me vjegëzën për pyetësin online, email adresën dhe detajet për kontaktim me telefon të hulumtuesit. Në mesin e përfaqësuesve të 38 komunave që ishin kontaktuar, 14 prej tyre janë përgjigjur në anketën online. Komunat që ishin pjesë e mostrës, janë të shënuara në tabelën 1:

Komunat	
1.	Ferizaj
2.	Glllogovc
3.	Hani i Elezit
4.	Kamenicë
5.	Klinë
6.	Leposaviq
7.	Lipjan
8.	Mamusha/
9.	Partesh
10.	Prishtinë
11.	Prizren
12.	Rahovec
13.	Suharekë
14.	Vushtri

Për të identifikuar problemet potenciale që mund të dalin gjatë administrimit të pyetësorëve në këtë fushë, UBO Consulting ka bërë një testim pilot të pyetësorëve, për të vërtetuar ata në kuptimin e përmbajtjes dhe logjikës. Po ashtu, pilot testi ka mundësuar krijimin e vërtetësisë (shkalla në të cilën pyetësi matë atë që është dashur të matë) dhe besueshmërinë (konsistenca e përgjithshme e brendshme) e pyetësorit. Ndryshimet e domosdoshme të pyetësorit janë bërë gjatë kësaj faze, përfshirë këtu: redaktimin ose riformulimin e pyetjeve, shtimi i filtrave për disa pyetje, etj. Faza finale e pyetësorëve prodhoi versionin final të anketës në tri gjuhë. Ndryshimet në pyetësor u pasqyruan në këto tri gjuhët: anglisht, shqip dhe serbisht.

Tabela 1: Administrimi i anketës online

3.2 Hulumtimi kualitativ

Në fazën e dytë të këtij studimi, UBO Consulting ka përdorur metoden kualitative të hulumtimit, kryesisht diskutimet online (intervistat të gjysmë strukturuara) dhe diskutime në grupe fokusi. Kjo metodë hulumtimi zakonisht përdoret për të nxjerrë informata të hollësishme nga përvojat komplekse personale, besimet dhe perceptimet e pjesëmarrësve. Duke marr parasysh masat anti-COVID 19 të qeverisë, studimi është kryer duke përdorur **platformat online (Zoom dhe Skype)**.

Intervistat gjysmë të strukturuara janë kryer me përfaqësuesit e njësive të QL-ve, që kanë marr pjesë në anketë online, për të marr informata më të hollësishme që kanë të bëjnë me çështjet që janë trajtuar nga pyetësi. Qëllimi i intervistave gjysmë të strukturuara ishte për të marr opinione më të hollësishme të të anketuarve, bazuar në përgjigjet e tyre në anketën online.

Për më tepër, për fazën e dytë të këtij studimi, UBO Consulting po ashtu, kreu në total pesë (5) diskutime në fokus grupe, me përfaqësuesit e nivelit lokal, qendrorë dhe sektorit privat. Në total ishin 53 pjesëmarrës, të kategorizuar si në tabelën 2:

Tabela 2: Administrimi i diskutimeve të grupeve të fokusit

Sektori 1: Administrata		
Nr. i GF.	Niveli lokal	Pozita:
1.	- Prishtinë - Mitrovicë - Kamenice - Klinë - Istog - Dragash - Junik - Shtime - Mamusha - Malishevë - Rahovec - Drenas - Ferizaj	- Drejtor të administratës

Sektori 2: Energjia

Nr. i GF.	Niveli lokal	Pozita:
2.	- Dragash - Kaçanik - Klinë - Novobërdë - Drenas - Viti - Mitrovicë - Rahovec - Prizren - Shtime - Gjakovë	- Zyrtarë për efikasitet energjetik
	Niveli qendror	Pozita:
	- Ministra e Ekonomisë dhe Mjedisit	- Zyrtarë i lartë për efikasitet të energjisë dhe kogjenerim - Zyrtarë i lartë për energji dhe statistika - Zyrtarë i lartë për RES - Zyrtarë i lartë për çështje sociale dhe të mjedisit - Drejtor i Departamentit për energji

Sektori 3: TIK dhe Open Data

Nr. i FG.	Niveli lokal	Pozita:
3.	Prishtinë Skenderaj Drenas Shtime	Zyrtarë për TIK Administrator i rrjetit të TI Drejtor i TI-së Drejtor
	Niveli qendror	Pozita:
	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI) Ministra e Ekonomisë dhe Mjedisit	Drejtor Drejtor i Departamentit për postë telekomunikim dhe teknologji informative dhe komunikim
	Kompanitë dhe organizatat	Pozita:
	Kode Labs Open Data	Bashkëthemelues & President Menaxher Projekti

Sektori 4: Shërbimet publike

Nr. i GF.	Komunat	Pozita:
4.	- Prishtinë - Mitrovicë - Skenderaj - Viti - Klinë - Dragash - Junik - Hani i Elezit - Kacanik - Shtime - Rahovec - Drenas	- Drejtor i shërbimeve publike dhe mbrojtje

Sektori 5: Planifikimi urban

Nr. i GF.	Komunat	Pozita:
5.	- Prishtinë - Prishtinë - Prizren - Pejë - Gjakovë - Suharekë - Shtime	- Drejtor i urbanizimit - Drejtor i urbanizimit dhe planifikimit strategjik

Grupet e fokusit ishin të ndara në kategoritë që paraqesin pesë sektorë madhor (administrata, shërbimet publike, planifikimi urban, energji dhe TIK e Open Data) për të identifikuar iniciativat Qyteti i Mençur. këto takime i ofruan mundësinë përfaqësuesve nga niveli lokal dhe ai qendrorë për të diskutuar për mjetet dhe inovacionet qyteti i mençur të planifikuara dhe tashme të zbatuara, për këmbimin e praktikave të mira në kornizën e zbatimit potencial. Pjesëmarrësit patën mundësinë për të diskutuar gjëra konkrete dhe në detaje sfidat që ata ballafaqohen në objektivat dhe mundësitë e Qytetit të Mençur dhe mundësitë për bashkëpunim ndër-komunal.

Të ftuarit potencial të diskutimeve të grupeve të fokusit, ishin përzgjedhur nga pozitat që tash i kanë në sektorët e pesë temave kryesore. Drejtorët nga të gjitha komunat nga pesë (5) sektorët e mësipërm dhe zyrtarët nga shumë institucione qendrore, ishin ftuar që të zvogëlojnë numrin e mosparaqitjeve. Pas identifikimit të listës së zyrtarëve për secilën temë, pjesëmarrësit u rekrutuan përmes email-it, pasuar nga një thirrje telefonike. Email-at përmbanin qëllimin e studimit, vjegëzën për takimin online dhe email adresën e kontaktet e telefonit të hulumtuesit. Në mesin e 165 përfaqësuesve komunal që ishin kontaktuar, në total, 53 përfaqësues ishin pjesë e diskutimeve në grupe fokusit.

Të gjithë pjesëmarrësit e konfirmuar, ishin kontaktuar një ditë para, për të ua përkujtuar vendin dhe diskutimet në grupe fokusit dhe për të konfirmuar pjesëmarrjen edhe një herë. Duke pasur parasysh gjendjen me pandeminë COVID 19, diskutimet u bënë online, me lidhje në njërën nga platformat online.

Diskutimet në grupe fokusit rezultuan si më të favorshmet për faktin se u mundësuan pjesëmarrësve që të shprehin në plotësi përvojat e tyre dhe të ndajnë praktikatat për iniciativat qyteti i mençur.

Pyetësi për anketë online dhe për diskutimet në grupet e fokusit, ishte i ndarë në temat në vijim:

- Njohuria/familjariteti me konceptin qyteti i mençur,
- Mjetet dhe inovacionet qyteti i mençur, të planifikuara dhe ato tashmë të zbatuara,

- Burimet e financimit të iniciativave qyteti i mençur,
- Kufizimet dhe sfidat me të cilat komunat/drejtoritë ballafaqohen në zbatimin e zgjidhjeve qyteti i mençur,
- Bërja prioritet e iniciativave qyteti i mençur në agjendë e komunës,
- Bashkëpunimi ndërmjet komunave, institucioneve të nivelit qendrorë dhe sektorit privat në planifikimin dhe zbatimin e zgjidhjeve qyteti i mençur,
- Ndikimi i pandemisë COVID 19 në strategjinë afatgjatë të zbatimit të mjeteve dhe inovacioneve qyteti i mençur,

- Pjesëmarrja e qytetarëve.


Tutje, UBO Consulting hartoi udhëzimet për diskutim. Këto udhëzime u fokusuan në temat e mbuluara nga studimi. Udhëzimet përbeheshin nga hyrja dhe seksioni i diskutimeve dhe me këtë, i ofronin moderatorit të ketë një përmbledhje të temave që do të diskutohen në këto takime. Intervistat gjysmë të strukturuar dhe diskutimet në grupe fokusi, ty dy këto, u kryen në gjuhën shqipe duke pasur parasysh se të gjithë pjesëmarrësit ishin folës të gjuhës shqipe.

4. Rezultatet

Seksionet në vijim shpalosin rezultatet e anketës online dhe intervistave gjysmë të strukturuar me përfaqësuesit e njësive të QL-ve dhe diskutimeve në grupe të fokusit me drejtorët komunal, zyrtarët e nivelit qendrorë dhe përfaqësuesit e kompanive dhe organizatave joqeveritare. Përmes këtij studimi, të lartpërmendurit, patën mundësinë të shprehin opinionet e tyre për disa çështje të caktuara, përfshirë këtu iniciativat Qyteti i Mençur që janë të planifikuara dhe të zbatuara si dhe sfidat me të cilat komunat ballafaqohen në zbatimin e mjeteve dhe teknologjive, burimet e financimit për iniciativat Qyteti i Mençur, masat e marra nga komunat për të bërë prioritet inovacionet Qyteti i Mençur në agjendat e tyre, ndikimin e pandemisë COVID 19 në mundësitë për ndryshimin e paradigmes për një jetë më kualitative dhe për rëndësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve në transformimin e qyteteve të së ardhmes.

4.1 Profili demografik i njësive të QL-ve.

Mostra e anketës online përbëhej nga 14 komuna. Në mesin e tyre, pesë qytete (35.71%) ishin me 60,000 dhe 150,000 banorë; katër qytete (28.57%) me 20,000 deri në 60.000 banorë, një qytet me më shumë se 150,000 banorë dhe katër qytete të vogla me më pak se 20,000 banorë (shih figurën 1). Në mesin e tyre, 12 qytete ishin shqiptare dhe dy prej tyre (qytete me më pak se 20,000 banorë) ishin serbe.



Intervistat e gjysmë të strukturuar janë mbajtur me përfaqësuesit nga komunat që kanë marr pjesë në anketën online. Pjesë e diskutimeve të grupeve të fokusit për pjesën kualitative të studimit ishin drejtorët komunal nga 26 komuna, zyrtarë nga institucionet e qeverisë qendrore dhe përfaqësues të kompanive dhe organizatave joqeveritare.

4.2 Familjariteti/njohuritë me konceptin qyteti i mençur

To begin with, initial questions from the online survey aimed to assess the respondent's opinion on the Smart City concept. Therefore, the questions from these sections aimed to discover how they assess their level of knowledge on smart cities and how they define Smart Cities.

The following graph shows the evaluation on the knowledge regarding the Smart City concept according to the respondents. Asked to rate their level of knowledge from 1 (no knowledge) to 5 (complete knowledge) on Smart City concept, the majority of respondents have declared to have knowledge to a moderate extent (28.57%) or knowledge to some extent (28.57%). There was only one municipality who confidently affirmed that they had complete knowledge on the Smart City Concept. On the other hand, two municipalities (14.29%) declared that they have no knowledge on this concept.




Figura 2: Si e vlerësoni nivelin e njohurive të zyrtarëve komunal për nocionin: Qyteti i Mençur?
Ju lutemi vlerësoni prej 1 deri në 5, ku 1 = s'ka njohuri dhe 5 = njohuri të plotë

Brenda të njëjtës temë të pyetjes, të anketuarit janë pyetur të zgjedhin një numër të pakufizuar ndërmjet deklaratave që më së mirë përshkruajnë konceptin Qyteti Mençur në komunën e tyre. Definicioni Qytetet e Mençura, për shumicën e komunave ishte asociacion me kontributin e realizimit të një vizioni gjithëpërfshirës për zhvillimin e qytetit (16.9%), pasuar nga digjitalizimi i qytetit (15.3%) dhe përmirësim i kualiteti të jetës së qytetarëve (13.6%). Vetëm 8.5% e të anketuarve i shihnin si komponentë për definimin e konceptit qyteti i mençur në komunën e tyre, përmirësimin e identitetit të qytetit, kualitetin më të lartë të planifikimit të projekteve dhe zbatimin e tyre.




Figura 3: Cilat deklarata përshkruaj më së miri konceptin Qyteti i Mençur në komunën tuaj?

Tutje, rezultatet nga të dhënat tregojnë se rrjetet sociale janë të parat në listë si burim i parë i informacionit për konceptin dhe iniciativat Qytetit të Mençur (30%). Të dytat në listë janë ngjarjet e organizuara/konferencat (17.5%), pasuar nga vebfaqet me përmbajtje për konceptin e qyteteve të mençura (15.0%) dhe punëtoritë/trajnimet për këtë temë (12.5%).




Figura 4: Si keni mësuar për konceptin dhe iniciativat Qyteti i Mençur?

Tutje, pjesëmarrësit janë pyetur që të rendisin gjashtë masa të ndryshme që do të ju ndihmonin atyre në zbatimin e projekteve qyteti i mençur nga ato më të rëndësishme tek ato të parëndësishme. Një vështrim i përciptë i figurës 5 tregon se 78.6% të anketuarve konsiderojnë se pjesëmarrja në konferenca Qyteti i Mençur është shumë e rëndësishme, gjatë kohës deri sa janë duke punuar në zhvillimin e mjeteve dhe inovacioneve Qyteti i Mençur në vendin e tyre. Të kesh një faqe interneti ku praktikant dhe mësimet e vendeve të tjera janë të paraqitura, ishte masa e dytë më e rëndësishme nga të anketuarit (71.4%). Veprimet e tjera përfshijnë; këmbimi i praktikave më të mira (64.3%), vlerësimi i procesit të bërit një qytet i mençur (64.3%), pranimi i mbështetjes nga hisedarët relevant (57.1%) dhe matja e progresit drejt konceptit të qytetit të mençur (42.9%)




Figura 5: Në angazhimet e juaj për tu bërë Qytet i Mençur, sa të rëndësishme mendoni se janë ...

Drejtorët komunal, gjatë diskutimeve në grupet e fokusit, kanë pasur mundësinë për të shtuar tutje për masat e mundshme. Në këtë kontekst, drejtori i administratës së Komunës së Dragashit sugjeroi që takimet me komunat që janë me veçori të njëjta, do të ishte e dobishme sikur ti ndanin përvojat e tyre me iniciativat. Ngjashëm me këtë, drejtori i administratës së Komunës së Suharekës deklaroi se takimet, konferencat dhe punëtoritë ku komunat kanë mundësi për të këmbyer përvojat, praktikat dhe mësimet e tyre, do të ishin shumë të dobishme, gjatë punës në transformim. Një pikë tjetër u ngrit nga Komuna e Ferizajit, që ka të bëjë me rëndësinë e të pasurit të një strategjie kombëtare për të nxitur zbatimin e projekteve qyteti i mençur dhe për të mësuar aktoret relevant për këtë temë dhe për rëndësinë e saj. Drejtorët e sektorëve tjerë mbështeten këtë pikë duke thënë se një strategji kombëtare, do të jepte udhëzime për zbatimin dhe menaxhimin e projekteve Qyteti i Mençur.

4.3 Iniciativat e planifikuara dhe të ndërmarra për të arritur objektivat drejt Qytetit të Mençur

Ky studim, mes tjerash, mëton të nxjerr në dritë mjetet dhe inovacionet Qyteti i Mençur që janë planifikuar apo zbatuar nga njësitet e QL-ve ose institucionet qendrore. Ngjashëm me seksionet e mësipërme, pjesëmarrësit u pyetën se a kanë zbatuar iniciativa Qyteti i Mençur në 12 fusha të ndryshme. Rezultate e studimit paraqesin se pjesëmarrja e qytetarëve përmes digjitalizimit të shërbimeve dhe arsimit/shëndetësisë, ishin projektet Qyteti i Mençur të zbatuara me përqindjen më të lartë (57.1%) nëpër komuna. Gjysma e komunave pjesëmarrëse në studim pretendojnë se kanë zbatuar teknologji Qyteti i Mençur në fushën e financave, Open Data dhe sisteme informimi. Dy fushat në fund të zbatimit të mjeteve inventive, sipas komunave, janë fushat e ujit, kanalizimit dhe bujqësisë. Mirëpo e për fat të keq, trendi i përgjithshëm tregon se një përqindje e madhe e komunave (65%), nuk kanë zbatuar mjete qyteti i mençur në asnjërën nga 12 fushat e shënuara.




Figura 6: A ka zbatuar ndonjë projekt Qyteti i Mençur komuna e juaj në ndonjërin nga fushat në vijim?

Për të marr informata të mëtutjeshme për iniciativat e planifikuara dhe për ato tashmë të zbatuara, përfaqësuesit e komunave në anketën online dhe pjesëmarrësit e diskutimeve në grupe të fokusit nga pesë sektorë të ndryshme, janë pyetur që të bëjnë një listë me iniciativat dhe masat e marra nga ata. Iniciativat e shënuara më poshtë janë kategorizuar në bazë të sektorëve.



Figura 7: Përmbledhje e iniciativave të planifikuara dhe të zbatuara në komunat e Kosovës të klasifikuara sipas sektorëve

4.3.1 Administrata

Si shumë qeveri tjera në botë, edhe Kosova ka shqyrtuar çështjen e digjitalizimit të shërbimeve administrative publike ekzistuese, për ti bërë ato më të qasshme për qytetarët. Në këtë drejtim, komunat tashmë kanë zbatuar masa të ndryshme, në mes tjerash, përmirësimin e pjesëmarrjes së qytetarëve. Ky seksion do të paraqes iniciativat e ndërmarra në sektorin e administratës.

Vetëshërbimet digjitale

E-Kiosku

një sistem automatik për nxjerrjen e dokumenteve nga regjistri civil i qytetarëve. Komuna e Prishtinës ka qenë e para që ka zbatuar këtë sistem për marrjen e dokumenteve digjitale nga regjistri civil i Kosovës në vitin 2015. Me 19 E-Kioska në dispozicion, komuna e Prishtinës mbulon 85% të kërkesave në total të qytetarëve për dokumente të statusit civil. Pas kësaj, 19 komuna tjera kanë ndjekur këtë shembull në krijimin e kioskave elektronike për nxjerrjen e dokumenteve. Në disa komuna si ajo e Suharekës, shërbimet e ofruar nga këto kioska elektronike janë zgjeruar edhe për nxjerrjen e certifikatave të pronës. Në të ardhmen, komuna e Suharekës planifikon të përparoj tutje këtë shërbim që do të ju lejoj qytetarëve të nxjerrin dokumente të tatimit komunal dhe të pronës.

Përderisa për qytetet me numër të madh të banorëve, përfitimet me paraqitjen e E-kioskave tejkalojnë shpenzimet për mirëmbajtjen e tyre, në vendet si Dragashi, ato nuk janë parë si të domosdoshme për shkak të madhësisë së vogël të komunës dhe popullatës së qytetit. Shpenzimet e mirëmbajtjes janë parë si të larta dhe të panevojshme duke pasur parasysh faktin se personeli i komunës mund të menaxhoj kërkesat e qytetarëve.

Si shtesë, Komuna e Prishtinës ka marr dy iniciativa drejt transformimit të shërbimeve administrative;

- Mundësinë për ti shtypur të gjithë formularët në secilën drejtori të Komunës së Prishtinës, dhe
- Dërgimin automatik të formularëve të plotësuar në Qendrën e shërbimit të qytetarëve.

Aplikimet online

U mundësojnë qytetarëve të aplikojnë online për dokumente që ju duhen dhe i marrin ato në adresën e banimit brenda dy (2) dite pune. Kjo rritë efikasitetin e administratës komunale dhe ndihmon në shmangien e rradhëve të gjata të pritjes për të marr dokumente. Të anketuarit nga komuna e Prishtinës, Gjakovës dhe Suharekës kanë deklaruar se ky shërbim është vënë në dispozicion të qytetarëve tyre. Drejtori i Administratës së Komunës së Prishtinës pohon se ata ofrojnë të gjitha llojet e shërbimeve online, në të njëjtën formë si të atyre që vijën fizikisht në komunë personalisht. Mirëpo, mungesa e informatave dhe/ose njohuritë e qytetarëve për këtë, paraqet disa kufizime në shfrytëzimin e këtyre mundësive.

One Stop Shop

Ky projekt është në zbatim në komunën në Ferizajit dhe Prizrenit. Përmes këtij projekti, komunat mëtojnë tu ofrojnë qytetarëve të tyre të gjitha shërbimet në një vend. Zyrat si ajo e pronës, tatimeve, zhvillimit ekonomik, për martesë dhe zyra e kadastrës, janë rimodeluar dhe riorganizuar për këtë qëllim. Duke integruar teknologjinë dhe digjitalizimin, ky shërbim ka arritur të thjeshtëzoj rreth 60% të 190 shërbimeve që ofrohen nga administrata publike. Kështu kanë deklaruar përfaqësuesit e komunës së Prizrenit. Me më shumë e 56 sportele, ku qytetarët mund të drejtojnë kërkesat e tyre, kjo teknologji do të jep rezultate në të qenit më efikas në përdorimin e burimeve të qytetarëve, duke kursyer kohën dhe parat njëkohësisht.

Kishte kufizime drejt zbatimit të projektit në tërësi sepse ka pasur kufizime sa i përket hapësirës në komunë, mirëpo, projekti ka qenë i suksesshëm pasi që qytetarët kanë mundësinë të kenë qasje në të gjitha shërbimet në një vend.

E- pagesat

Qëllimi i kësaj është të shtypet fatura për mbeturina për të kursyer kohë, shpenzime dhe të gjurmohet bilanci i tatimit në pronë gjatë tërë kohës. Si shtesë, tatimpaguesit mund të bëjnë pagesën përmes sistemit bankar. Kjo iniciativë tashmë është zbatuar në shumë komuna.

Platforma digjitale për pjesëmarrje publike (PDPP) ³

PDPP-ja është një platformë që ka për qëllim të përmirësoj transparencën e institucioneve publike duke ofruar një mjedis që përmirëson komunikimin ndërmjet zyrtarëve komunal dhe qytetarëve. Aktualisht, kjo platformë është në dispozicion në komunat; Prishtinë, Prizren, Gjakovë dhe Kamenicë. Qytetarët kanë qasje dhe mund të propozojnë projekte për lagjet e tyre si dhe të votojnë për projektet që tashmë janë propozuar dhe kanë mundësi që të kontribuojnë në dizajnin e qytetit që funksionon për të gjithë.

² Gjakova Online. Nxjerrë nga: <https://gjakova.e-komuna.com/>

³ Platforma Digjitale. Nxjerrë nga: <https://platformadigjitale.com/>

Ditari digjital

Ditari digjital është një iniciativë që është ndërmarr nga Komuna e Ferizajit. Ditari digjital ka për qëllim të kontribuoj në sistemin e arsimit duke ofruar qasje prindërve në kohë reale për progresin e fëmijëve të tyre. Prindërit, fëmijët e të cilëve shkojnë në shkollat publike, mund të kenë qasje në notat dhe vijueshmërinë e fëmijëve të tyre.

Qasja në dokumente publike

Është krijuar një faqe interneti me informatat për dokumentet që janë të qasshme për publikun dhe si qytetarët mund ti marrin ato.

ndreqe.com⁴

ndreqe.com është një platformë online që mbledh dhe adreson brengat e qytetarëve nëpër komuna. Këtë e bënë duke ofruar mundësinë për qytetarët që lehtësisht raportojnë brengat e tyre dhe i shërben komunave për të pasur qasje të lehtë në brengat e qytetarëve. Problemet në vijim mund të raportohen tek ndreqe.com; ndriçimi publik, problemet me trotuar, shenjat e rrugëve, pengesat për qytetarët me aftësi të kufizuara, sistemi i kanalizimit dhe mbeturina. Platforma është në dispozicion për të gjithë qytetarët e të gjitha komunave dhe qytetarët mund të përdorin lokacionin e tyre aktual për të raportuar ndonjë problem. Tutje, përmes platformës, qytetarët mund të informohen në kohë reale për veprimet e ndërmarra për brengat e tyre.

4.3.2 Shërbimet publike në emër të brengave

Mjetet e mençura dhe inovacionet kanë për qëllim transformimin e zonave urbane në vende të pastra, të sigurt dhe të rehatshme ku qytetarët kënaqen me jetën. Në këtë seksion do të paraqiten zgjidhjet që kanë për qëllim përmirësimin e shërbimeve publike që marrin qytetarët dhe të transformojnë vendet e tyre të hapësira që ja vlen të jetohet.

Kamerat e sigurisë

Me qëllim të ofrimit të sigurisë në hapësirat publike, shumë komuna kanë instaluar kamera të sigurisë për vëzhgim. Drejtori i shërbimeve publike në Komunën e Prishtinës deklaroi se ata ia kanë dalë që të instalojnë këto kamera në ndërtesat institucionale, në shkolla dhe në sheshin kryesor të qytetit. Kamerat më tutje do të vendosen edhe nëpër lagje të qytetit me ndihmën e disa organizatave. Drejtorët e shërbimeve publike të komunave Skenderaj, Shtime dhe Klinë raportua se kanë ndërmarr hapa të ngjashëm duke instaluar kamera të sigurisë që monitorohen nga policia e Kosovës dhe mund të gjurmohen secilin në çdo kohë.

² Gjakova Online. Nxjerrë nga: <https://gjakova.e-komuna.com/>.

³ Platforma Digjitale. Nxjerr nga: <https://platformadigjitale.com/>.

⁴ Ndreqe.com. Nxjerr nga: <https://ndreqe.com/>.

Menaxhimi i mençur i mbeturinave

Integrimi i sistemeve të mençura për të monitoruar mbledhjen e mbeturinave, është pjesë e masave që shumë komuna planifikojnë të zbatojnë. Ndër zgjidhjet e propozuara është edhe vendosja e sistemeve GPS në kamionë që mbledhin mbeturinat, duke ofruar kështu të dhëna në kohë reale për lokacionet ku mbledhen mbeturinat. Kjo do të përparonte monitorimin e mbledhjes së mbeturinave dhe do të rriste efikasitetin. Si shtesë, kjo do të u jepte qytetarëve qasje për të kontrolluar se a janë duke u mbledhur mbeturinat e tyre. Iniciativat e tjera të propozuara përfshijnë përdorimin e sensorëve, për të detektuar kur kontejnerët e mbeturinave janë mbushur dhe të dërgojnë njoftimin tek kompania për të mbledhur kontejnerët në lokacione specifike.

Paralelisht me këtë, komuna e Mitrovicës planifikon të instaloj pajisje që mund të detektojnë kur një person hedh kanaqe në shportat e mbeturinave dhe këto japin personit 15 minuta Wi Fi dhe mundësinë për të mbushur telefonin kur i hedhin kanaqe. Zgjidhje të tilla janë propozuara nga drejtoritë për shërbime publike edhe në komunat tjera.

Senzora për matjen e ndotjes së ajrit

Sa më shumë njerëz që jetojnë në zona urbane, kjo do të thotë më shumë aktivitet ekonomik, shpenzim energjie dhe më shumë emetim të gazrave serë (GHG). Për këtë gjë, të dhënat për kualitetin e ajrit janë bërë shumë të rëndësishme për vlerësimin e efekteve të iniciativave në ndotjen e ajrit dhe mjedisit. Sensorët për matjen e ndotjes së ajrit janë instaluar në gjashtë pika kyçe në qytetin e Prishtinës. Si shtesë e parametrave aktual, norma e lejuar e ndotjes sipas rregulloreve të BE-së është bërë normë dhe këto parametra mund të krahasohen.

Duke informuar qytetarët për kualitetin e ajrit, ata mund të zgjedhën të dalin jashtë apo jo në ditët kur ajri është i ndotur. Njëjtë me këtë iniciativë, edhe komunat e Suharekës dhe e Shtimes planifikojnë të vendosin 7 sensorë të ndotjes së ajrit në vende të ndryshme që do të ju ofronin qytetarëve të dhëna në kohë reale për nivelin e ndotjes së ajrit. Po ashtu, Drenasi në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit ka vendosur pika të matjes së kualitetit të ajrit.

TE Pema T

"TE Pema T" është prodhim vendor që pastron ajrin në qytet dhe është i përbërë nga pemët që kanë aftësi të madhe të filtrimit të ajrit dhe prodhimin të oksigjenit. Kjo është e mundur duke ju falënderuar aranzhimit, pozitës dhe sistemit automatik të ujitjes që i bënë këto bimë të filtrojnë ajrin me kapacitet maksimal.

4.3.3 Planifikimi urban dhe mobiliteti

Sistemi i transportit është njëri ndër shkaktarët kryesor të ndotjes së ajrit. Duke qenë të vetëdijshme për këtë fakt, shumë komuna kanë bërë planet e qëndrueshme të mobilitetit për transportin rrugor, duke filluar nga përmirësimi i infrastrukturës së transportit publik deri tek inkurajimi për mjete transporti më të mira për mjedisin dhe kufizimi i qasjes së automjeteve në qendrën e qytetit. Ky seksion i vënë në një listë iniciativat e planifikuara për këtë gjë.

Përmirësimi i infrastrukturës së transportit publik⁵

Komuna e Prishtinës në planin e saj për mobilitet të qëndrueshëm urban, propozon të ofroj infrastrukturë të duhur për përdorimin e transportit publik duke quar tek zvogëlimi i përdorimit të veturave. Veprimet e planifikuara në këtë drejtim janë:

- Krijimi i stacioneve qendër të autobusëve me hapësira për pritje dhe informim dhe stacione autobusi me strehim për udhëtarët.
- Sistemi i ri i informimit për transportin publik do të ofroj informata në kohë reale për automjetet që do të jenë online dhe në stacione autobusi. Ky shërbim do të tërheq më shumë udhëtar duke ofruar përdorim të rehatshëm të transportit publik, duke ofruar informata për automjetet që ata mund ti përdorin dhe orarin e tyre të lëvizjes.⁵

- Sistemi i integruar i biletave që mundëson blerjen e biletave të autobusit përmes shitoreve në rrugë dhe bileta elektronike përmes Bus App, për të përshpejtuar kohën e hyrjes në autobus.⁵
- Rindërtimi i stacioneve të autobusit për të rritur kualitetin e transporti publik dhe për të siguruar qasje për të gjithë.

Masa të ngjashme janë të parapara edhe me projektin "Mbështetje për një Prizren të qëndrueshëm – Inicimi i veprimit urban kombëtarë të zvogëlimit e gazrave serë (NAMA)" që synon të promovoj përdorimin e modeleve të qëndrueshme të transportit që kontribuojnë në zvogëlimin e emetimeve të GHG-ve në komunën e Prizrenit. Masat e planifikuara për sektorin e transportit përmes planit të investimeve ndër-sektoriale, që do të ndihmojnë komunën e Prizrenit të arrij caqet e zvogëlim-it të emetimit të GHG-ve janë:

- Inkurajimi për përdorimin e transportit publik, veturave elektrike dhe formave të qëndrueshme të transportit si ecja dhe biçikleta.⁶
- Ngritja e vetëdijes tek qytetarët që të inkurajojnë ndryshim në sjellje.⁶
- Trajnimi i qytetarëve dhe profesionistëve për të nxitur këto ndryshime.⁶

Në këtë drejtim, drejtori për urbanizim i komunës së Shtimes deklaroi se ata planifikojnë të ndërtojnë një stacion autobusi për autobusët transit që ndalen në Shtime, për të ju ofruar qytetarëve një infrastrukturë të duhur për përdorimin e autobusëve. Po ashtu, ngritja e kapaciteteve të transporti publik duke vënë në dispozicion më shumë autobus, është theksuar edhe nga Drejtoria për urbanizim e komunës së Mitrovicës.

Përmirësimi i infrastrukturës për këmbësor dhe për biçikleta

Së bashku me përmirësimin e infrastrukturës për transport publik, komunat do të sigurojnë që të përmirësojnë edhe infrastrukturën për këmbësor dhe çiklistë. Bërja e mobiliteti të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, ku qytetarët mund të udhëtojnë lehtësisht dhe kanë qasje, është në thelbin e planin të mobilitet të qëndrueshëm të komunës së Prishtinës. Ndër veprimet e propozuara që kanë për qëllim inkurajimin e çiklizmit dhe të ecjes janë:

Skema e përmirësuar për këmbësorë⁵

përmirësimi i hapësirave për këmbësor duke krijuar mjedis të sigurt për ecje dhe duke inkurajuar qytetarët të përdorin mënyra tjera transporti e jo veturat e tyre. Si shtesë e kësaj, plani i ri i mobilitetit propozon ndërtimin e zonave për këmbësor dhe çiklizëm si pjesë e rrjetit të integruar, që është në funksion të gjithë qytetarëve dhe përmirëson kushtet për ecje, çiklizëm dhe transport të lehtë në udhëtimin e tyre.

Zbatimi i skemës për marrjen me qira të biçikletave dhe parkim për biçikleta dhe motoçikleta⁵

që ofron qasje të lehtë, të sigurt dhe të lirë në biçikleta për qytetarët. Duke e bërë të mundshme marrjen me qira të biçikletave me orë apo në baza ditore, do të inkurajoj qytetarët që të orientohen në këtë formë të transporti në qytet. Si shtesë kësaj, qytetarët do të kenë mundësi të marrin biçikletën në një vend dhe ta kthejnë atë në një vend tjetër. Kjo e bën më të lehtë për ta qasjen në to dhe udhëtimin.

Shtigjet për biçikleta⁵

janë pjesë e masave për biçikleta, në emër të planit për mobilitet të qëndrueshëm. Përveç krijimi të shtigjeve të reja për çiklist dhe përmirësimi të shtigjeve aktuale, do të merren masa edhe për përmirësimin e sigurisë së çiklistëve.

Inkurajimi për përdorimin e biçikletave është bërë prioritet kryesorë për shumë komuna derisa ato janë duke punuar në planin e mobiliteti të qëndrueshëm. Drejtori i planifikimit urban, kadastër dhe gjeodezi i komunës së Shtimes ka deklaruar se në kornizën e planit të mobilitetit, ata kanë krijuar përgjatë tri rrugëve kryesore shtigje për biçikleta që përafërsisht kanë një gjatësi prej 24 km. Gjithashtu, sipas drejtorit për urbanizim, shtigjet për biçikleta janë bërë prioritet edhe në komunën e Mitrovicës, ku janë duke u zhvilluar politika të veçanta për urbanizim, mbrojtje të mjedisit dhe menaxhim të mbeturinave.

Komuna e Prizrenit ka në projekt masa të ngjashme me iniciativat për ndërtimin e zonave të gjelbra për një mjedis të qëndrueshëm dhe të shëndoshë. Disa nga veprimet që do të ndërmerren në këtë drejtim janë:

- Krijimi i zonave të gjelbra për këmbësorët dhe zonave të gjelbra.
- Ofrimi i stacioneve për karikim të veturave elektrike
- Krijimi i stacioneve të autobusëve me sisteme të mençura.
- Vërja në dispozicion e biçikletave.
- Krijimi i zgjidhjeve të gjelbra për rrugët dhe shtigjet.

Kufizimi i veturave që kanë qasje në qendër të qytetit

ka për qëllim të zvogëloj emisionet e krijuara nga automjetet, duke vendosur masa shtesë kontrolli për llojet e automjeteve që kanë qasje në qendër të qytetit. Rreth 1.5 milion ton prodhohen nga karburantet që digjen nga veturat në një vit në Kosovë. Kufizimi i disa llojeve të automjeteve që kanë qasje në qendra të qyteteve është njëra nga alternativat e mundshme për të ulur këto shifra.

Zona parkimi me pagesë për zona të banuara në komunën e Prishtinës⁹

do të ndihmojnë në zvogëlimin e numrit të veturave në trafik që kërkojnë vend parkim dhe rregullon veprimet e parkimit në qendër të qytetit. Këto zona parkimi do të përdorin sistemin e digjitalizuar të integruar të bazuar në vendet e zhvilluara, duke përdorur sistemet e mençura të pagesës dhe sensorët për të detektuar vend parkimet që janë të lira. Zonat e parkimit janë të ndara në tri zona për parkim. E para është më së afërmi qendrës së qyteti dhe njëherë më e shtrënjta. Një sistem i mençur i pagesave do të ju mundësoj qytetarëve ti bëjnë pagesat përmes aplikacionit për parkim, përmes SMS-ve nga operatorët telefonik në Kosovë (Vala dhe Ipko), biletave apo kioskave.

⁷ Mbështetje për një Prizren të qëndrueshëm – Iniciimi i veprimit urban kombëtarë të zvogëlimit gazrave serë (NAMA)*. Marrë nga: <https://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/projects/sup-port-for-sustainable-prizren--initiating-urban-namas--nationa.html?fbclid=IwAR2rEPAPVap7h8dPMnmoQHZLJsszuUGlkVJiiqXWnSQSkMw57cTSGeO0-g>

⁸Ekonomia e veturave. Marrë nga: <https://veturat.institutigap.org/>

⁹Prishtina Parking. Marrë nga: <https://www.prishtinaparking.net/>

Banorët do të kenë një përparësi sepse ata do të kenë parkimin e rezervuar me pagesë mujore. Vetura e parë e një familje do të ketë parkimin pa pagesë por nga ata kërkohet që të paguajnë për secilën veturë shtesë që posedojnë. Kjo do të bëhet me qëllim të zvogëlimit të numrit të vetura në pronësi.

Krijimi i hapësirave për parkim dhe për udhëtim

Ky koncept ka për qëllim të zvogëloj trafikun në qendër të qytetit, duke ofruar hapësirë për parkim në терминаlet e transportit publik në zonat e skajshme të rrugëve radiale. Qytetarët me biletën e parkimit, do të kenë mundësi të shfrytëzojnë transportin publik. Kjo do të jetë një stimulim për ta të shfrytëzojnë transportin publik për të shkuar në qendër të qytetit. Kjo do të rezultojë në numrin e zvogëluar të veturave në qendër të qytetit, pasi që një numër i madh i vizitorëve që udhëtojnë çdo ditë me veturat e tyre për ardhur në punë, do të parkojnë veturat e tyre në zonat e largëta dhe do të shfrytëzojnë transportin publik për të hyrë në qendër të qytetit.

Parkimi nëntokësor

ka për qëllim të zgjidh problemin e parkimit në rrugë. Kjo do të rezultojë në hapësira shtesë për këmbësorët dhe do të rris hapësirën në rrugë pasi që veturat nuk do të parkohen në to. Parkimi do të përdor sensorët për të ofruar të dhëna në kohë reale për përdoruesit, për atë se a ka vend-parkime të lira për secilën zonë parkimi, në mënyrë që ata të mos humbin kohë në trafik duke kërkuar vend-parkim të lirë. Njëkohësisht, kjo do të zgjidh problemin e trafikut në qendër të qytetit, duke pasur parasysh se 30% e trafikut shkaktohet nga veturat që kërkojnë një vend-parkim. Kjo masë do të aplikohet në harmoni me iniciativën për zona të ngarkuara. Duke marr parasysh që veturat do të duhet të parkohen afër qendrës së qytetit, ato përndryshe do të detyrohen të paguajnë një tarifë për hyrje.

⁸Ekonomia e veturave. Marrë nga: <https://veturat.institutigap.org/>

⁹Prishtina Parking. Marrë nga: <https://www.prishtinaparking.net/>

4.3.4 Energjia

Njëri nga aspektet që duhet të merret parasysh për të arritur qëndrueshmërinë, është përdorimi i burimeve të ripërtërijshme të energjisë, për të përmbushur nevojat për energji të qytetarëve. Pra, për të zvogëluar përdorimin e konsumimit të energjisë nga burimet jo të përtërijshme, duhet të konsiderohen burime alternative për prodhimin e energjisë, për mobilitetin, ngrohjen dhe për veprime tjera. Ky seksion paraqet masat që janë ndërmarr nga komunat dhe institucionet qendrore drejt zvogëlimit të konsumit të energjisë dhe zëvendësimit të burimeve jo të ripërtërijshme të energjisë me ato alternative dhe jo ndotëse.

Vendosja e ngrohjes qendrore

Njëra nga iniciativat që qeveria ka marrë në drejtim të zvogëlimit të harxhimit të energjisë, është vendosja e ngrohjes qendrore në disa komuna si Ferizaji, Gjilani, Peja, Prizreni dhe Mitrovica. Kjo iniciativë planifikon të zvogëloj kërkesën për rrymë elektrike dhe të rris efikasitetin në nivelin qendrorë dhe atë lokal. Deri më sot, ngrohja qendrore është në dispozicion vetëm në komunat Prishtinë, Gjakovë dhe Mitrovicë. Drejtori i shërbimeve publike në Shtime ka shtuar se edhe ata planifikojnë të ndërtojnë sistemin e ngrohjes qendrore.

Futja e ngrohjes qendrore do të ketë efekt në zvogëlimin e ndotjes duke ofruar stimulim për qytetarët që sistemin e tyre individual të ngrohjes ta zëvendësojnë me atë qendrorë, që janë të bazuar në ndotës të lartë.

Efikasiteti energjetik

Shumica e komunave kanë plan të përbashkët të efikasiteti energjetik. Në mes tjerash, ky plan përfshin rinovimin e ndërtesave institucionale, objekteve të shëndetësisë dhe shkollave. Paralelisht me renovimet, është lansuar një platformë, ku komunat mund të gjurmojnë kursimet energjetike pas renovimit ose intervenimeve. Përmes programit, komunat mund të gjurmojnë zvogëlimin e burimeve të energjisë që përdoren për ngrohje, p.sh. pas renovimit. Të punësuarit janë trajnuar nga projekti, për të siguruar se ata kanë shkathtësitë të përdorin platformën. Projekte tjera nga donatorët, do të mundësojnë rinovimin e shtëpive të banimit dhe banesave, për të siguruar kursime afatgjata në energji. Iniciativa tjera për zvogëlimin e shpenzimit të energjisë ishin ato për zëvendësimin e ndriçimit publik me poçe ekonomike dhe efikase. Zyrtari për efikasiteti energjetik nga Drenasi ka konfirmuar se ata kanë investuar në zëvendësimin e dritave të vjetra me drita LED, që ka quar në zvogëlimin prej 50% të shpenzimit të energjisë.

Zyrtari i lartë për efikasitet energjetik dhe ko-gjenerim nga Ministria e ekonomisë dhe mjedisit shtoi se, po ashtu, ka iniciativa tjera që po merren nga qeveria, për krijimin/projektimin e planeve për energji dhe klimë dhe rishikime të strategjisë për energji. Plani për energji dhe klimë është duke u projektuar për periudhën kohorë 2021 – 2030, me një parashikim deri në vitin 2050.

4.3.4 Energy

Tutje, rishikimi i strategjisë së energjisë është duke marr parasysh politikat e reja që qojnë drejt rritjes së efikasitetit energjetik, zvogëlimit të emetimit të gazrave, fuqizimit të stabilitetit dhe sigurimit të rrjetit. Ka orvatje të futet gazi si burim i energjisë, që do të rezultonte në rritjen e stabilitetit energjetik, rritjen e shumëllojshmërisë së burimeve të energjisë dhe do të fuqizonte komunat në privatizimin e sektorit të energjisë dhe zhvillimit.

Prizren Green Growth Center (PGGC)- Prizreni i qëndrueshëm¹⁰

Prizren Green Growth Centre (PGGC) është themeluar në emër të projektit "Mbështetje për një Prizren të qëndrueshëm – Inicimi i veprimit urban kombëtarë të zvogëlimit të gazrave serë (NAMA)". Objektivi kryesor projektit Mbështetje për një Prizren të qëndrueshëm – Inicimi i veprimit urban kombëtarë të zvogëlimit të gazrave serë (NAMA)" është të përmirësoj kualitetin e jetës së qytetarëve të Prizrenit, duke zvogëluar emetimin e gazrave serë (GHG). Kjo zyrë planifikimi dhe mbikëqyrje, ndihmon komunën të caktoj prioritet kryesorë që kanë të bëjnë me klimën dhe të identifikoj dhe të caktoj prioritet dhe veprimet zbutëse urbane. Po ashtu, projekti ka për qëllim të bashkoj hisedarët e ndryshëm, duke shërbyer si vendtakim për institucionet relevante që kanë punuar ndaras në fushën e zhvillimit të gjelbër. Veprimet e tjera që janë marrë në luftimin e ndryshimeve klimatike në emër të këtij projekti janë:

- Studim i fizibilitetit për instalimin e paneleve solare në ndërtesat publike.¹⁰
- Krijimi i inventarit të emetimit të gazrave serë, me të dhëna nga emetimet të drejtpërdrejta dhe indirekte të emisioneve GHG nga sektorët e energjisë, bujqësisë, mbeturinave, përdorimit të tokës, proceseve industriale dhe përdorimit të produkteve industriale.¹⁰
- Plani i intervenimeve ndër-sektoriale përfshinë rreth 74 veprime në sektorët e energjisë, menaxhimin e mbeturinave, transportit dhe shërbimeve publike.¹⁰

Masat e planifikuara në emër të planit të investimit ndër-sektorial në sektorin e energjisë janë:

- Marrja e veprimeve për bërjen e ndërtesave efikase me energji dhe me këtë të kontribuohet në zvogëlimin e emisioneve të gazrave serë¹⁰
- Inkurajimi i përdorimit efikas të energjisë në ndërtesat e banimit.¹⁰
- Inkurajimi i përdorimit efikas të energjisë për ngrohje dhe ndriçimin e hapësirave publike.¹⁰
- Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe të brendshme në institucione për energji.¹⁰
- Ngritja e vetëdijes dhe promovimi i dobive të sjelljes që promovojnë zvogëlimin e shpenzimit të energjisë dhe zvogëlimin e gazrave serë.¹⁰

¹⁰ Mbështetje për Prizrenin e qëndrueshëm, Plani ndër-sektorial i intervenimit (CSIP). Marrë nga: <https://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/projects/sup-port-for-sustainable-prizren--initiating-urban-namas--nationa.html?fbclid=IwAR2rEPAVap7h8dPMnmoCHZL1sszuUGlKVJiiqXWnSQSkiMw57cTSGe00-g>

Sistemi i ngrohjes qendrore duke përdorur energjinë solare

Duke marrë parasysh shkallën e rritjes së popullatës në Prishtinë, parashihet që deri në vitin 2029 edhe 13500 konsumatorë të rinj do të kenë kërkesa për ngrohje qendrore. Janë ndërmarr disa veprime për të zëvendësuar një pjesë të madhe të prodhimit të nxehtësisë me energji solare, në regjionin e Prishtinës. Objektivi kryesor i këtij projekti është rritja e efikasitetit energjetik dhe kursimet. Në të njëjtën kohë, kjo rrit kapacitetet e ngrohësorëve të qytetit, rritë efikasitetin, zgjeron rrjetin, zvogëlon konsumin e rrymës elektrike dhe e bënë sistemin më të qëndrueshëm. Me përdorimin e kolektorëve solar-termal, nxehtësia absorbohet nga drita e diellit për ngrohur ujin. Uji i ngrohur pastaj shpërndahet përmes rrjetit të ngrohjes qendrore. Ngrohtorja do të ruaj energjinë nga panelet solare gjatë verës dhe do të përdor Sistemin e transmissiionit të kombinuar të ngrohjes dhe energjisë për ngrohje gjatë dimrit.

Nga kjo do të përfitojnë diku 4000 objekte banimi shtesë me 18000 banorë të kryeqytetit. Zëvendësimi i ngrohjes me rrymë elektrike dhe zvogëlimi i emisioneve të shkaktuara nga termocentrali me lignit, do të jenë përfitimet kryesore nga kjo iniciativë. Një përfitim tjetër do të jetë edhe ai që individët do të inkurajohen të zëvendësojnë sistemin individual të ngrohjes siç janë stufat (ngrohje me dru) dhe do të ketë një efekt madhorë në zvogëlimin e ndotësve të dëmshëm dhe klimën.¹¹

Energjia e erës¹²

Në vizionin e qytetit të mençur, ka një numër në rritje të kompanive që prodhojnë energji përmes instalimit të turbinave të erës. Një investim në gjenerimin e energjisë së erës është miratuar në veri të Kosovës, i cili përfshinë instalimin e 27 turbinave të erës që do të ndihmojnë në gjenerimin e rreth 105 MW dhe do të shpërndahet në komunën e Vushtrrisë.

Nga numri total i entiteteve që janë miratuar nga Zyra e rregullatorit të energjisë, do të prodhohen 114.4 MW duke përdorur turbinat e erës. Këto projekte do të kenë efekt të drejtpërdrejt në zvogëlimin e emisioneve të dhe do të ofrojnë zgjidhje të favorshme për mjedisin duke prodhuar energji.

Energjia solare¹³

Me qëllim të diversifikimit të burimeve të energjisë, investimet që shfrytëzojnë përfitimet nga energjia termale solare kanë nisur të zënë vend. Instalimi i paneleve solare ndihmon të mbulohen nevojat e qytetarëve për energji, pa krijuar ndotje. Nga aplikimet e miratuara nga Zyra e rregullatorit të energjisë, një kapacitet energjie prej 20 MW do të prodhohet nga panelet solare të instaluara. Për më tepër, miratimi i entiteteve nga faza e autorizimeve preliminare, do të kontribuoj në gjenerimin e energjisë deri në 82.27 MW. Qëllimi është që të mbulohen nevojat për energji të familjeve në këto zona, duke shmangur krijimin e emisioneve të dëmshme të dyoksid karbonit.

¹¹ Kosovë, Rrjeti i ngrohjes qendrore i Termokosit – Projekti solar termal, Studim para-fizibiliteti

¹² <https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publicimet/BRE/1.1.2.2020%20Regjistri%20i%20Aplikuesve%20p%C3%A8r%20Autorizim%20dhe%20Pranim%20ne%20Skemen%20Mbe....pdf>

¹³ <https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publicimet/BRE/1.1.2.2020%20Regjistri%20i%20Aplikuesve%20p%C3%A8r%20Autorizim%20dhe%20Pranim%20ne%20Skemen%20Mbe....pdf>

4.3.5 TIK-u dhe Open Data

37

Ndriçimi i hapësirave publike me energji solare

Energjia solare është bërë burim i ndriçimit të hapësirave publike dhe rrugëve të komunave: Ferizaj, Pejë, Gjakovë, dhe Shtime. Komuna e Ferizajit planifikon zbatimin e iniciativave të ngjashme edhe në pjesë tjera të qytetit si dhe konsideron se ky është një hap i madh drejt zgjidhjeve për një përdorim efikas të energjisë. Drejtori për efikasitet energjetik nga komuna e Drenasit deklaroi se gjatë vitit të ardhshëm, ndriçimi publik do të transformohet në sistemin e mençur. Komuna e Prizrenit planifikon të përdorë energjinë solare si burim të energjisë në ndërtesat e administratës dhe ato publike. Të gjitha këto iniciativa, mëtojnë që të rrisin efikasitetin energjetik dhe do të paraqesin burime të ripërtërijtshme të energjisë dhe u ofrojnë qytetarëve një infrastrukturë të duhur.

Qytetet e mençura po transformojnë zona e tashme urbane dhe rurale, duke përmirësuar kualitetin e jetës së qytetarëve, nga mobiliteti dhe mjedisi deri tek uji dhe energjia. Teknologjitë e mençura kërkojnë të dhëna që janë të hapura dhe mund të jenë qasshme, të këmbyeshme dhe mund të përdoren nga publiku falas. Seksioni në vijim i vë në listë iniciativat e planifikuara dhe të zbatuara të fushave të Open Data dhe teknologjisë digjitale, të cilat kanë për qëllim të rrisin transparencën dhe përdorin të dhënat për krijimin e zgjidhjeve të mençura.

Open Data Kosova¹⁴

Portali ku të dhënat janë të paraqitura është i formatit të hapur nga administrata publike e Kosovës. Portali menaxhohet nga Agjencia e shoqërisë së informacionit (ASHI), e cila mëton ti ofroj shoqërisë informata që janë bërë të qasshme nga institucionet qeveritare. Deri më tash, në dispozicion janë 205 sete të të dhënave që mund të nxirren në formate të ndryshme dhe të procedohen tutje. P.sh. Komisioni i rregullatorit të prokurimit publik poston në baza mujore listën dhe planet e prokurimit.

E- Kosova

Është një platformë në fazën e para lansimit dhe menaxhohet nga Agjencia e shoqërisë së informacionit (ASHI). Platforma ka për qëllim të bëjë të gjitha shërbimet për qytetarët në një vend, përfshirë këtu aplikimet online dhe pagesat elektronike. Përmes kësaj platforme, qytetarëve do të ju duhet vetëm një llogari për të gjitha shërbimet e sektorëve të ndryshëm që ju nevojiten. Kjo e bën më të lehtë përbushjen e kërkesave të tyre. Në të njëjtën kohë, qytetarët mund të kenë informata në kohë reale për fazat e procedimit në të cilat është kërkesa e tyre. Drejtori i përgjithshëm i ASHI-së shtoi se përmes kësaj vebfaqe, qytetarët mund të aplikojnë për çfarëdo dokumenti dhe të marrin atë përmes e-mail-it. Për më tepër, ata mund të përcjellin kërkesën e tyre në kohë reale në vebfaqe po ashtu.

¹⁴ Open Data Kosova. Marrë nga: <https://opendata.rks-gov.net/>.

¹⁵ Pristina Open Data. Marrë nga: <https://opendata.pristinaonline.com/>.

¹⁶ Shtyllat e mençura. Marrë nga: <http://smartpoleskosovo.com/>

¹⁷ <https://www.ipko.com/smart-agro/agro-sms/>

¹⁸ <https://www.agrilinks.org/post/innovation-and-climate-risk-mitigation-protect-kosovos-agricultural-sector-competitiveness>

¹⁹ Financimi dhe fondet për Qytetet e Mençura në ekonomitë në zhvillim

Pristina Open Data¹⁵

Në orvatje për rritjen e transparencës në punë, kryeqyteti ka krijuar platformën Prishtina Open Data, për ti vënë të dhënat në dispozicion të publikut. Të dhënat mbledhen nga departamente të ndryshme dhe paraqiten në formë pamore, për tu kuptuar më lehtë. Të dhënat mund të përdoren për analiza të mëtutjeshme nëse është e nevojshme. Vërja e të dhënave në dispozicion të qytetarëve ofron transparencë në qeverisje në komunën e Prishtinës, përgjegjshmëri dhe pjesëmarrje të publikut. Kjo platformë përfshinë në total 17 kategori, përfshirë këtu punën e kryetarit të komunës.

Shtyllat e mençura¹⁶

Ky është një projekt i zbatuar nga Ministria e ekonomisë dhe mjedisit (MEM), përmes Ekonomia digjitale e Kosovës. Duke përdorur teknologjinë, ata ia kanë dalë të rregullojnë infrastrukturën e rrjetit fizik të internetit të shpejtë, me fibra optike në zonat e largëta të Kosovës. Një investim i rëndësishëm është instalimi i shtyllave të mençura në tri fshatra, më saktësisht në Dol, Breznicë dhe Reçan. Duke përdorur energjinë solare, këto pajisje përdoren për të ofruar shërbime si: monitorimin e ajrit dhe parametrave tokësor, kamerat e sigurisë, sistemin e zërit publik, ndriçimin e mençur, Wi-Fi falas, USB, etj. Drejtori i Departamentit të postës dhe telekomunikacionit dhe TIK-ut në MEM deklaroi se "ne, po ashtu, kemi furnizuar shkollat me pajisje të mençura dhe nxënësit mund të vendosin reklama të ndryshme dhe të shprehin kreativitetin e tyre". Përmes këtyre projekteve, ata kanë synim përmirësimin e jetës së qytetarëve në këto zona.

Bujqësia e mençur¹⁷

Ky projekt përdor mjetë të mençura për të ju ofruar bujqve informata në kohë reale për kushtet atmosferike në regjionin e Gjakovës, Junikut, Deçanit, Pejës, Podujevës, Kamenicës, Vitisë, Obiliqit dhe Rahovecit. Në stacionet agrologjike janë vendosur sensorë që gjenerojnë informata në kohë reale për shtypjen atmosferike, erën etj., dhe shfrytëzohen edhe për parashikimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve të ndryshëm. Këto të dhëna agrologjike ofrohen për bujqit falas në një format që interpretohet dhe kuptohet lehtë.

Regjistrimi i mençur i pronës.

Teknologji të ngjashme janë zbatuar në Krushë të Madhe, Kosovë, për të ju ofruar pronarëve të tokave fletë-posedimin me të drejtat pronësore. Janë përdorur mjete fluturues pa pilot, të njohura si dron, për të xhiruar hapësirën tokësore mbi fshat dhe me këtë kanë bërë regjistrimin e tokës në fshat. Kjo u ka mundësuar grave të veja të aplikojnë për kredi duke ofruar dëshmi të drejtën pronësore dhe të themelojnë kooperativat e tyre të biznesit. Teknologji të ngjashme që përdorin harta me rezolucion të lartë, mund të përdoren për të detektuar ndërtime ilegale, pasi që qytetet në Kosovë vazhdojnë të zgjerohen me shpejtësi të madhe, posaçërisht gjatë viteve të fundit.¹⁹

Platforma të ngjashme janë duke zhvilluar nga organizatat joqeveritare, kompanitë dhe institucionet e tjera, për të shpaluar të dhëna nga institucionet qeveritare dhe për të mundësuar pjesëmarrjen e publikut. Duke e bërë këtë, ato kontribuojnë drejt një qeverisje më transparente dhe efikase dhe janë dëshmitarë të rëndësishëm të hisedarëve tjerë dhe jo vetëm të institucioneve publike, për të pasur qytete më të qasshme dhe më transparente.

Buxheti i shtetit²⁰

Është një projekt në platformën e Institutit GAP. Ky projekt u ofron qytetarëve mundësinë të shohin të dhënat që kanë të bëjnë me ndarjen e buxhetit dhe shpenzimet publike për të gjitha organizatat buxhetore (OB) të nivelit qendror dhe atij lokal. Secila e dhënë i dërgon qytetarët në seksione të ndryshme, varësisht nga institucioni, lloji i shpenzimit, agregatet ekonomike (rrogat dhe pagat, mallra dhe shërbime, shpenzime kapitale, komunalitë dhe rezervat), dhe bënë klasifikimin bazuar në funksionalitetin, ekonominë dhe kategoritë institucionale.

ID-ja e Komunës²¹

përmes kësaj platforme, qytetarët mund të marrin të gjitha informatat që nisin nga numri i të punësuarave në institucione publike, tek numri i nxënësve në shkolla, numri i bizneseve që operojnë në sektorë të ndryshme, buxheti, skenat e kursimeve pensionale.

Si shtesë e kësaj, ato të dhëna mund të përditësohen, siç kanë premtuar kryetarët e komunave dhe ata që kanë zbatuar projekte të tilla deri më tash.

Bizneset e hapura²²

Është një platformë që ofron informata për bizneset aktive në Kosovë. Të dhënat e paraqitura aty janë në një format që lehtë kuptohet dhe janë vizuale. Përveç informatave për numrin e bizneseve, aty mund të kesh qasje edhe në informata tjera si: numri i të punësuarve, lloji i biznesit, ndarja e bizneseve nëpër komuna, etj.

²⁰ Si i shpenzon shteti paratë tona? Marrë nga: <https://www.institutigap.org/spendingsEng/>

²¹ ID-ja e Komunës. Marrë nga: <https://www.komunat.institutigap.org/>

²² Bizneset e hapura. Marrë nga: <http://biznesetehapura.com/en>

4.4 Financimi i iniciativave Qyteti i Mençur

Pjesë e rëndësishme e këtij hulumtimi ka qenë identifikimi i burimeve financiare të iniciativave Qyteti i Mençur. Në këtë drejtim, pyetja fillestare ka qenë se a kanë ndarë mjete qeveritë lokale për teknologjitë e qyteteve të mençura siç janë sensorët, softveri parashikues dhe gjërave të tjera, kur kanë planifikuar projektet infrastrukturore. Shumica e përfaqësuesve komunal në anketën online (71.43%) kanë deklaruar se kanë ndarë buxhet për mjete për qytetin e mençur.




Figura 8: A ndanë qeveria lokale zakonisht mjete të caktuara për financimin e teknologjive qyteti i mençur (senzorë, softver për monitorim dhe parashikim, etj.) kur planifikon infrastrukturë fizike (transport, ujë, energji, teknologji të komunikimit, etj.)?

Komunat që deklaruan se ndajnë buxhet për iniciativa qyteti i mençur, janë pyetur tutje për sasinë e mjeteve të ndara. Gjysma e tyre (50%) deklaruan se ata ndajnë 1-deri në 5% të buxhetit të tyre për mjete qyteti i mençur. Një e pesta prej tyre ndajnë 1% dhe 25% prej tyre ndajnë 5 deri në 10% të buxhetit të tyre.





Figura 9: Nëse po, mesatarisht, cila është përqindja e buxhetit të projektit që zakonisht ndahet për teknologjitë "Qyteti i Mençur"?

Mjetet Qyteti i Mençur dhe inovacionet vijnë paralel me investime të mëdha në infrastrukturë dhe kapacitete të brendshme. Janë identifikuar dy burime kryesore për financimin e iniciativave Qyteti i Mençur; fondet publike nga qeveritë lokale dhe ajo qendrore (50%) dhe fonde nga organizatat donatore ndërkombëtare (42.86%).



Këto dy burime financimi të iniciativave qyteti i mençur janë theksuar, po ashtu, edhe gjatë diskutimeve në grupe fokusi me drejtorët komunal. Drejtori i urbanizmit nga komuna e Suharekës ka deklaruar se ata kanë marrë mbështetje financiare nga qeveria për ndërtimin e stacionit të autobusëve dhe janë duke pritur për donacione për të siguruar financimin e projekteve që kanë për qëllim përmirësimin e kualitetit të ajrit. Në komunat tjera, fondet nga organizatat donatore ndërkombëtare, janë shtytësi kryesorë për zbatimin e këtyre projekteve. Disa nga shembujt janë: The Green Growth Centre në Prizren, menaxhimi efikas i energjisë në komuna etj.

Figura 10: Cilat janë burimet e financimit të "Qytetit të Mençur": projektet e zbatuara në komunën tuaj?

4.5 Kufizimet dhe sfidat

Për të parë vështirësitë me të cilat ballafaqohen komunat në zbatimin e mjeteve të Qytetit të Mençur dhe inovacionit, pjesëmarrësit në studim (përmes anketës online dhe diskutimeve në grup) janë pyetur për sfidat dhe kufizimet me të cilat ata ballafaqohen deri sa punojnë në agjendën Qyteti i Mençur.

Nuk ishte befasi se në krye të listës së vështirësive, nga drejtorët komunal, u gjend në përgjithësi mungesa e buxhetit dhe fondeve komunale për financimin e investimeve në këto teknologji (27.1%) dhe në mirëmbajtje (shih figurën 11). Si shtesë kësaj, drejtorët komunal theksuan që buxheti është kufizimi kryesor, posaçërisht për iniciativat që kërkojnë investime masive si krijimi i teknologjive të reja për digjitalizimin e proceseve administrative ose investime në burime të ripërtërijshme të energjisë.

"Fatkeqësisht, çmimi i mirëmbajtjes së e-Kioskave që përdoren për automatizimin e proceseve për nxjerrjen e dokumenteve të regjistrimit për administratën është shumë i lartë. Kjo bënë shumë komuna që të mos jenë në gjendje ti përballojnë këto shpenzime."

- Drejtori i administratës, Komuna e Ferizajit.

Është me rëndësi të theksohet se kufizimet në fonde, janë identifikuar si sfida e përbashkët në të gjitha diskutimet në grupe fokusi (administrata, shërbimet publike, TIK-u, Open Data dhe energjia).



Figura 11: Cilat nga çështjet e mëposhtme paraqesin barriera për komunën tuaj në zbatimin e teknologjive "qyteti i mençur"?

Paralelisht me kufizimet buxhetore, mungesa e ekspertizës teknike (12.5%), planet afatgjate (12.5%), nevoja për mbështetje infrastrukturore (10.4%), dhe mungesa e kapaciteteve të brendshme (6.3%) plotësojnë listën e pesë barrierave kryesore në komuna. Duke qenë të brengosur me mungesën e ekspertizës teknike të stafit, drejtorët komunal në diskutimet në grupe fokusi kanë përmendur se përveç investimeve në infrastrukturën teknologjike, duhet të bëhen edhe orvatje në ngritjen dhe përparimin e shkathtësive të fuqisë punëtore. Ata kanë tërhequr vëmendjen te nevoja për trajnime të zyrtarëve për procedurat dhe politikat e iniciativave të reja, për të ju dhënë atyre shkathtësitë e nevojshme për të punuar në këto sisteme.

Infrastruktura mbështetëse për zbatimin e teknologjive Qyteti i Mençur, është një sfidë e përbashkët e identifikuar nga drejtorët e administratës, energjisë, TIK-ut dhe Open Data që morën pjesë në diskutimet në grupe fokusi. Shumë komuna kanë deklaruar se ata nuk mund të mbështesin infrastrukturën e nevojshme as financiarisht dhe as stafi nuk i ka kapacitetet për ta mbajtur këtë, posaçërisht në sektorët e energjisë dhe transformimit digjital, ku nevojiten investime të stërmëdha. Në administratë, p.sh. dështimi i rrjetit ka rezultuar në mosfunksionimin e shumë E-Kioskave për nxjerrjen e dokumenteve të regjistrimit civil në zonat e largëta.

"Infrastruktura aktuale në Republikën e Kosovës paraqet problem, pasi që kemi investime të mëdha kapitale që janë të lidhura me sektorin e diversifikimit të energjisë, rritjen e sigurisë së rrjetit dhe çështje tjera të ngjashme"

- Zyrtari i lartë për efikasitetin në energji dhe në kognjencë – Ministria e ekonomisë dhe mjedisit.

Kur flasim për mungesën e kapaciteteve të brendshme që janë të domosdoshme për mirëmbajtjen e iniciativave qyteti i mençur, një i anketuar deklaroi:

"Ne kemi vetëm një zyrtar të teknologjisë informative që është i punësuar në komunë dhe ai është afër pensionimit. Kjo paraqet një problem sepse ne jemi njëra nga komunat më të mëdha në nivelin kombëtar."

- Drejtori i administratës – Komuna Ferizaj

Përgjigje të ngjashme janë paraqitur nga drejtorët e sektorëve tjerë. Në komunën e Prishtinës, nevoja për rritjen e kapaciteteve të brendshme është kryesore, posaçërisht në departamentin e TI-së. Në komunat tjera si Klina dhe Dragashi, drejtorët e shërbimeve publike kanë theksuar se mungesa e stafit zyrtarë që do të përkujdeset për mirëmbajtje, ka rezultuar në dështimin e paraqitjes së zgjidhjeve të mençura që do të përmirësojnë kualitetin e shërbimeve që ju ofrohen qytetarëve.

Zyrtari për TI në komunën e Drenasit ka theksuar:

"Departamentet e TI-së nuk janë të përgatitura për ndryshime të tilla sepse ato kanë vetëm një zyrtarë të TI-së që mbikëqyrë të gjithë zyrtarët. Ky departament nuk është prioritet për komunat dhe për këtë ka mbetur i pazhvilluar"

– Komuna Drenas – Zyra e TI-së – Drejtoria e administratës.

Çështjet tjera që u ngritën nga drejtorët e komunave janë: koordinimi ndërmjet departamenteve dhe institucioneve, nevoja për planifikim afatgjatë dhe pjesëmarrja e shoqërisë civile që do të jenë përdoruesit përfundimtar të këtyre mjeteve dhe inovacioneve.

4.6 Bërja prioritet e iniciativave Qyteti i Mençur në agjendën komunale

Njëra nga pjesët më të rëndësishme të këtij studimi ishte vrojtimi i përkushtimit të komunave në bërjen prioritet iniciativat qyteti i mençur në agjendat e tyre. Sipas rezultateve të hulumtimit, pjesëmarrësit ofruan përgjigje të ndryshme në raport me fushën që konsiderohet më e lehta për zbatuar në qytetin e tyre. Të anketuarit ofruan katër fusha kryesore ku zgjidhjet qyteti i mençur janë zbatuar. 30% shënuan qeverisjen si fusha më e lehtë për zbatimin e zgjidhjeve të mençura, rreth 21% konsiderojnë mjedisin të jetë fusha më e lehtë dhe të 48% të tjerëve e ndanë baras ndërmjet mobiliteti dhe ekonomisë.




Figura 12: Në mesin e komponentëve të konceptit Qyteti i Mençur, cila duket më e lehtë për tu zbatuar në qytetin tuaj?

Tutje, komunat janë pyetur për përkushtimin e përgjithshëm për integrimin e iniciativave qyteti i mençur në agjendat e tyre. Shumica prej tyre (57.14%) u përgjigjen se zbatimi i iniciativave qyteti i mençur konsiderohet të jetë prioritet i lartë për qytetin e tyre.




Figura 13: Si do ta karakterizonit përkushtimin e përgjithshëm e komunës tuaj me rastin e zbatimit të iniciativave Qyteti i Mençur

Kur shikon tutje në bërjen prioritet në agjendë të iniciativave Qyteti i Mençur, bazuar në numrin e banorëve të komunave, lehtësisht mund të vërehet se i kanë prioritet këto investime a jo. Kjo varet pothuaj plotësisht nga numri i qytetarëve që duhet tu japin shërbime (shih tabelën 3). Përdorisa për qytetet me më pak se 20000 banorë këto iniciativa konsiderohen si prioritet ulët ose nuk janë prioritet fare, për qytetet me 60000 deri 150000 banorë dhe qytetet me më shumë se 150000 banorë, këto iniciativa janë prioritet i lartë për tu ofruar qytetarëve të tyre shërbime.

Tabela 3: Si do ta karakterizonit përkushtimin e përgjithshëm e komunës tuaj me rastin e zbatimit të iniciativave Qyteti i Mençur bazuar në madhësinë e komunës?

	Qytet me më shumë se 150,000 banorë	Qytet 60,000-150,000 banorë	Qytet 20,000-60,000 banorë	Qytezë me total nën 20,000 banorë	Total
Prioritet i lartë	100.0%	100.0%	50.0%	0.0%	57.1%
Prioritet mesatar	0.0%	0.0%	50.0%	0.0%	14.3%
Prioritet i ulët	0.0%	0.0%	0.0%	50.0%	14.3%
Nuk është prioritet fare	0.0%	0.0%	0.0%	50.0%	14.3%

Tutje, studimi mëtoi të identifikoj sektorët ku këto teknologji konsiderohet si prioritet. Bazuar në rezultatet e hulumtimit, të anketuarit kanë identifikuar më së shpeshti teknologjitë qyteti i mençur në sektorin e shëndetësisë, arsimit, dhe shërbimeve njerëzore dhe shërbime të konsumatorëve/përfshirje të publikut. Më shumë se gjysma e të anketuarve (57.1%) konsideronin këto iniciativa si prioritet i lartë në këto fusha: siguria publike (35.7%), ndotja e ajrit dhe mbrojtja e mjedisit (35.7%), energjia (35.7%) pagesat elektronike dhe financat inteligjente (35.7%) dhe Open Data (35.7%) ishin në krye të listës si prioritetet e shtatë sektorëve në të cilat teknologjitë qyteti i mençur u identifikuan nga të anketuarit (shih figurën 14).




Figura 14: Çfarë niveli të prioritetit kanë teknologjitë qyteti i mençur për komunën tuaj sektorët në vijim?

Mbështetja për konsumatorët dhe pjesëmarrja e qytetarëve, konsiderohen si prioritetet të larta dhe kjo është konfirmuar edhe në diskutimet e grupeve të fokusit. Drejtori i administratës së komunës së Suharekës ka pohuar se shumë iniciativa të ndërmarra nga komuna e Suharekës në drejtim të integritetit të teknologjive qyteti i mençur dhe digjitalizimit të sistemeve administrative, janë indikator që qeveria lokale e ka bërë integrimin e teknologjive qyteti i mençur një prioritet. Në anën tjetër, shumë zhvillime në këtë fushë, e kanë hapur rrugën për qytetet e tjera ta ndjekin shembullin, sepse, ata e kuptojnë tash se integrimi i teknologjive qyteti i mençur në sektorin e tyre administrativ është faktori më i rëndësishëm për zhvillim.

Është vërejtur një përgjigje e përbashkët nga drejtorët e urbanizmit, drejt bërjes prioritet lëvizjet që rezultojnë në mbrojtje të mjedisit. Në komunën e Mitrovicës, iniciativat që merren në fushën e planifikimit urbanistik, përfshijnë harmonizimin ndërmjet infrastrukturës dhe politikave mjedisore. Drejtori i urbanizmit nga komuna e Mitrovicës deklaroi se "zakonisht, më shumë se 90% të buxhetit shkon në infrastrukturë". Ndaj, komuna e Mitrovicës për momentin është duke punuar në përgatitjen e planeve që mbrojnë mjedisin dhe zgjerojnë hapësirat e gjelbra, duke marrë në konsideratë infrastrukturën. Një proces i natyrës së njëjtë është duke ndodhur në Shtime, ku bashkëpunimi ndërmjet mbrojtjes së mjedisit dhe infrastrukturës është duke u vendosur. Kjo po bëhet duke investuar në ndërtimin e parqeve, shtimit të ndriçimit efikas, duke ju përmbytur ligjit për mbrojtjen e ujërave dhe iniciativa të ngjashme.

4.7 Bashkëpunimi ndërmjet hisedarëve

Zhvillimi i zgjidhjeve teknologjike për qytete të mençura, kërkon bashkëpunim ndërmjet institucioneve publike nga niveli lokal dhe ai qendrorë dhe nga ndërmarrësit privat dhe novatorët. Bashkëpunimi ndërmjet këtyre aktorëve ka qenë njëri nga aspektet e vlerësuara në këtë pyetësor.

4.7.1

Bashkëpunimi ndër komunal

Pyetja fillestare në këtë temë ishte për bashkëpunimin ndër komunal. Në përgjithësi, shumica e drejtorëve deklaruan se ka një mungesë bashkëpunimi ndërmjet komunave. Kjo paraqet një sfidë për ta, deri sa punojnë në transformimin e qyteteve të tyre në vende të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Drejtorët e administratës nga komunat, u pajtuan se nuk ka aspak apo fare pak bashkëpunim ndërmjet komunave në zgjidhje të mençura dhe mjete që zbatohen në administratat e tyre. Mirë po, vlen të shënohet se komunat treguan gatishmëri për bashkëpunim të mundshëm. Drejtori i administratës së Dragashit, sugjeroi që të organizohet një takim, në të cilin do të ndaheshin tregimet e suksesit dhe dështimet. Kjo do të ndihmonte në zhvillimin e teknologjive qyteti i mençur si dhe do të përparonte bashkëpunimin ndër komunal. Jashtë kësaj, komunat e Suharekës dhe Drenasit janë shembuj të bashkëpunimit ndër komunal që janë marrë me vetë-iniciativë, për të ndarë përvojat në iniciativat për efikasitet në energji.

Spektori i TIK-ut the Open Data, kanë ndërmarr veprime drejt përparimit të bashkëpunimit ndër komunal. Kolegjiumi i teknologjisë informative është një tentim i Asociacionit të komunave të Kosovës (AKK), që i bënë bashkë drejtorët nga departamentet e TIK-ut nga sektore të ndryshëm të komunave të Kosovës. Drejtori i Kolegjiumit të teknologjisë informativë, që funksionon si pjesë e AKK-së, deklaroi se ata janë duke ndërmarr iniciativë drejt digjitalizimit të shërbimeve dhe të disponueshmërisë së informatave online për qytetarët në çdo komunë.

Ngjashëm me këtë, Qendra për inovacion dhe zhvillim të projekteve, është një entitet i zhvilluar në komunën e Shtimes dhe ofron mundësi për krijimin e mjeteve të mençura dhe inovacione, që bashkojnë bizneset, studentët dhe institucionet lokale.

4.7.2

Bashkëpunimi i nivelit lokal dhe atij qendrorë

Zgjidhjet qyteti i mençur nuk janë vetëm përgjegjësi e qyteteve dhe kompanive. Komunitet kanë nevojë për ndihmën e qeverisë për të ofruar infrastrukturën e domosdoshme dhe mbështetje për bërjen realitet të këtyre zgjidhjeve inventive. Kur u pyeten për bashkëpunimin me institucionet e nivelit qendrorë, përgjigjet ishin ndryshe në varësi të sektorëve.

Sa i përket aspektit të Open Data, mund të vërehet një ndjenjë e bashkëpunimit ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendrorë. Ky bashkëpunim përfshinë vendosjen e parakushteve për transformimin digjital të shërbimeve tradicionale, në një tentim për të rritur bashkëpunimin ndërmjet hisedarëve që promovojnë iniciativat Qyteti i Mençur. Zyrtari i lartë për efikasitet energjetik dhe kogjenerim konsideron se mbështetja dhe bashkëpunimi ndërmjet qeverive lokale dhe asaj qendrore është rritur viteve të fundit. Proceset e trajnimit dhe ndërtimit të kapaciteteve në fushën e efikasitet të energjisë, janë duke u bërë njëkohësisht në të dy nivelet.

Agjencia e Kosovës për efikasitet në energji (AKEE) ka themeluar një partneritet me zyrtat lokale për energjinë në nivelin lokal.

Mirëpo, drejtori për planifikim urban i komunës së Mitrovicës ka deklaruar se mungesa e bashkëpunimit ndërmjet qeverisë lokale dhe qeverisë, rezulton të jetë një nga sfidat më të mëdha që në adresimin e zbatimit të mjeteve dhe inovacioneve qyteti i mençur. Një problem tjetër që ka lidhje me bashkëpunimin ndërmjet hisedarëve është edhe gatishmëria për bashkëpunim ndërmjet institucioneve lokale dhe atyre qendrore. Ngjashëm me këtë, drejtori i administratës nga komuna e Dragashit është i brengosur me nivelin e gatishmërisë për të dhënë përgjigje nga nivelit qendrorë për brengat e ndryshme që shtrohen nga qeveritë lokale.

4.7.3

Bashkëpunimi ndërmjet kompanive dhe sektorit publik.

Për fund, qytetet e mençura kanë ofruar një mundësi për sektorin privat dhe kompanitë tjera që të bashkëpunojnë me institucionet qeveritare, për tu marr me sfidat urbane si trafiku, ndotja e ajrit, kualiteti i ujit dhe mbeturinat. Me krijimin e infrastrukturës nga qeveria dhe duke ju ofruar të dhëna kompanive, kompanitë mund të përqendrohen krijimin e zgjidhjeve që janë në të mirë të qytetarëve. Bashkëthemeluesi dhe drejtori i Kode Labs, një kompani me përvojë në qytete të mençura nga Detroiti, Michigan, theksoi se bashkëpunimi ndërmjet kompanive dhe institucioneve është crucial, për ndërtimin e qyteteve të mençura.

"Do të jetë e pamundur të vazhdohet me çfarëdo projekti pa Open Data. Ata duhet të dinë se në cilin drejtim janë duke shkuar vendi dhe qytetet. Ata duhet të ofrojnë të dhëna në mënyrë që kompanitë të dinë se çka është e nevojshme në qytete që ata të ofrojnë projektet në atë fushë."

- Bashkëthemelues dhe Drejtor i Kode Labs

Sa i përket nivelit të bashkëpunimit në institucione të Kosovës, Zyrtaari i lartë për efikasitet në energji dhe kogjenerim nga Ministria e ekonomisë dhe mjedisit, beson se bashkëpunimi ndërmjet institucioneve qeveritare dhe sektorit privat, reflektohet në procesin e bërjes së politikave. Ai ofroi një shembull të projektimit të politikave të Planit për energji dhe klimë, ku ka pasur një numër të madh të entiteteve të përfshira si organizata joqeveritare, kompani private, përfaqësues biznesesh dhe organizata ndërkombëtare.


"Bashkëpunimi është në rritje, për të lehtësuar zbatimin e zgjidhjeve të mençura".

- Zyrtaari i lartë për efikasitet në energji dhe kogjenerim, Ministra e ekonomisë dhe mjedisit.

Përfaqësuesi nga Open Data Kosova (ODK) ndau një përvojë të bashkëpunimit të mirë me institucionet publike, për zhvillimin e platformave që do ti shërbejnë qytetarëve. Mes tjerash, ata theksojnë bashkëpunimin me komunën e Prishtinës për zhvillimin e platformës "Kontratat e hapura", që informon qytetarët për proceset e prokurimit dhe kontratat. Mirë po, kjo nuk është gjithmonë kështu dhe varet shumë nga institucioni që është i përfshirë. Në mes tjerash, përfaqësuesit nga ODK deklaruan se në disa raste, zyrtarët ngurronin të ndanin të dhëna për shkak të keqkuptimeve për të dhëna publike, për brenga për privatësinë. Në raste tjera, institucionet nuk kishin të dhëna, gjë që e thekson më tepër nevojën për të pasur të dhëna në dispozicion për të ju mundësuar kompanive të bëhen pjesë e ekosistemit që dizajnon mjete të mençura dhe zgjidhje.

4.8 Ndikimi i COVID-19 në planifikimin Qyteti i Mençur.

Lufta e botës me COVID 19 ka kthyer vëmendjen e institucioneve kah nevoja për zgjidhje të mençura. Shumë qytete kanë shfrytëzuar përparësinë e digjitalizimit, teknologjisë dhe të dhënave publike për të menaxhuar shpërndarjen e virusit. Pasi që pandemia theksoi nevojën për zgjidhje të mençura për planifikim të qytetit, qeveritë filluan të ri-konsiderojnë pozicionimin ndaj teknologjive të mençura në hierarkinë e buxheteve të tyre. Një çështje e rëndësishë së veçantë për këtë studim ka qenë të shihet efekti i COVID 19 në krijimin e mundësive për integrimin e zgjidhjeve qyteti i mençur. Të gjithë të anketuarit (100%) deklaruan se teknologjitë Qyteti i Mençur ishin të nevojshme në luftën me pandeminë COVID 19.



Po

Figura 15: mendoni se teknologjitë Qyteti i Mençur ishin të nevojshme për tu ballafaquar me pandeminë COVID 19?
[Me teknologji Qyteti i Mençur mendojmë zgjidhjet në fusha të ndryshme si transporti, infrastruktura, shërbimet publike, mjekësia, arsimit etj.]

Tutje, ata u pyetën se a i është rritur vlera zgjidhjeve Qyteti i Mençur që nga shpërndarja e pandemisë COVID 19. Shumica e pjesëmarrësve (85.72%) pohuan se rëndësia e këtyre mjeteve është rritur shumë/në masë të madhe.




Figura 16: A u është rritur vlera e përdorimit zgjidhjeve të mençura që nga shpërndarja e pandemisë COVID-19?

Të anketuarit patën mundësinë të ndajnë nëse ata kanë ndërmarr ndonjë iniciativë që nga shpërndarja e pandemisë. 64.29% pohuan se ata kanë korrur përfitime nga inovacionet qyteti i mençur në luftën me pandeminë.




Figura 17: A keni ndërmarrë ndonjë iniciativë të konceptit "Qyteti i Mençur" që nga shpërndarja e pandemisë COVID-19?

Për të kuptuar tutje informatat për iniciativat Qyteti i Mençur, të ndërmarra nga komunat, secili nga të anketuarit u pyet për të bërë një listë zgjidhjeve të mençura të bëra, në tentim për të menaxhuar situatën e krijuar nga pandemia COVID 19. Iniciativa e ndërmarra nga komunat, që nga shpërndarja e pandemisë, janë të përmbledhura më poshtë:

- Portali Online me informata për COVID 19 (Prizren, Prishtinë, Suharekë, Kamenicë), ku qytetarëve u janë ofruar informata për veprimet që duhet të ndërmerren në rast se atyre u shfaqen simptoma, ku mund të kërkojnë ndihmë psikologjike, si të mbrojnë veten si dhe numrave në kohë reale për rastet që kanë rezultuar pozitiv me COVID 19 në komunë.
- Platforma online për ndihmë financiare për bizneset.
- Platforma online për aplikim për ndihmë financiare për njerëzit që janë testuar pozitiv me COVID 19 (Komuna e Prishtinës)
- Platforma për mësim online. (komuna e Prizrenit)

Sipas rezultateve të diskutimeve në grupet e fokusit, pjesëmarrësit ofruan përgjigje të ndryshme kur bëhet fjalë për ndryshimin e mënyrës së jetesës së qytetarëve, si përgjigje ndaj situatës së krijuar nga COVID 19. Drejtori i urbanizmit nga komuna e Mitrovicës deklaroi se ata kanë vërejtur një rënie në numrin e qytetarëve që shfrytëzojnë transportin publik dhe rritje të numrit të qytetarëve që përdorin veturat private, për shkak të brengave të sigurisë për të qenë në turmë. Një përvojë plotësisht tjetër ishte nga komuna e Shtimes. Sipas drejtorit për urbanizim nga komuna e Shtimes, qytetarët, përfshirë këtu të rinj dhe të moshuar, kanë filluar të përdorin biçikleta në vend të veturave dhe hapësirat e gjelbra u dukeshin më atraktive për të kaluar kohën pasi që restorantet dhe baret u mbyllën. Duke pas parasysh këtë ndryshim në sjellje tek qytetarëve, komuna filloi të bëjë prioritet masat që përmirësojnë infrastrukturën për biçikleta dhe u ofron më shumë hapësira për aktivitete rekreative.

Përfaqësuesit nga sektorët e TIK-ut dhe Open Data theksuan se COVID 19 nuk i gjeti të gjithë qytetarët nga grupet-moshat e ndryshme të gatshëm për të u përshtatur me ndryshimet digjitale dhe teknologjike. Tutje, drejtori për urbanizim nga komuna e Mitrovicës deklaroi se komuna e tyre ka ofruar shumë shërbime online që në kushte normale kërkohej nga qytetarët ta vizitojnë fizikisht institucionin. Qytetarët nuk e përdorën këtë përparësi dhe ata nuk kanë vërejtur rritje të numrit të përdoruesve për shërbimet online.

"Zhvillimi i aplikacioneve nuk është problemi kryesorë në Kosovë. Problemi është në pjesën e prapme ose në kurajon dhe motivimin për përdorimin e burimeve të tilla. P.sh. mësuesit dhe profesorët kanë pasur të gjitha "pajisjet" e domosdoshme për mësim online por ata nuk kishin kurajo ose nuk dinin të përdornin teknologjinë".

- Drejtori i departamentit për postë, telekomunikacion, teknologji të informacionit dhe komunikimit, Ministria e ekonomisë dhe mjedisit.

Për fund, bashkëthemeluesi dhe drejtori nga KODE Labs sugjeroi se ndryshimet që kanë ardhur për shkak të pandemisë, kanë krijuar mundësi për zgjidhje Qyteti i Mençur. Ai sugjeron se komunat mund të përcjellin shembujt e vendeve tjera si Shtetet e Bashkuara dhe të fillojnë të krijojnë zgjidhje që u shërbejnë popullit gjatë këtyre kohërave, kur ata e kalojnë pjesën më të madhe të kohës në shtëpi. Ai futi si temë diskutimi shembullin e mjeteve të mençura për të gjurmuar kualitetin e ajrit brenda mureve të shtëpive, që janë lehtë për tu instaluar dhe për tu mirëmbajtur.

4.9 Pjesëmarrja e qytetarëve

Qytetet e mençura përdorin teknologjitë e informimit dhe komunikimit me qëllim të ofrimit të zgjidhjeve në fushat e mobilitetit, energjisë, qeverisjes, arsimit dhe të tjera. Mirë po, arritja e objektivave të tyre është e mundur vetëm nëse qytetarët, si shfrytëzuesit e fundit të këtyre teknologjive, bëhen pjesë e dizajnit të qytetit. Kjo i bënë qytetarët aktor, e jo vetëm pjesëmarrës të këtyre zgjidhjeve inventive teknologjike. Në njërin anë, kjo kërkon investim nga qeveria në teknologji, rrjet të telekomunikacionit të vendit dhe programe për të siguruar se qytetarët kanë të gjitha mjetet për të marrë pjesë në botën online. Në anën tjetër, përshtatja me teknologjinë qyteti i mençur, kërkon një popullatë që është rehat me këtë teknologji dhe ofron informata kthyesë aktive.

Mes tjerash, të anketuarit patën mundësinë të ndajnë veprimet që ata kanë ndërmarr për edukimin e qytetarëve, që të sigurojnë një pjesëmarrje aktive të tyre. Shumica e të anketuarve vënë në krye të listës rrejtët sociale si burim primar i ngritjes së vetëdijes për iniciativa të reja dhe për të u ofruar qytetarëve instruksione për përdorimin e tyre. Një veprim i mirënjohur, që është marr nga komunat, është zhvillimi i platformave në vebfaqet e tyre që edukojnë qytetarët dhe ofrojnë udhëzime për mjetet e reja në dispozicion, që e bëjnë ofrimin e shërbimeve më të lehtë për ta.

Drejtori i administratës nga komuna e Rahovecit ndau përvojën me fushatën për edukimin e qytetarëve për nxjerrjen e dokumenteve përmes E-kioskave. E-kioskët në komunën e Rahovecit kanë nga dy ekrane. Njëri ekran paraqet informata për qytetarët duke paraqitur hapat e nevojshëm që duhet të ndërmerren kur ta përdorin shërbimet e E-kioskave dhe ekrani tjetër përdoret për të operuar dhe zgjedhur shërbimet që u nevojiten.

Tutje, zyrtari për efikasitet në energji në komunën e Drenasit pohoi se ata kanë punuar në ngritjen e vetëdijes tek bizneset dhe qytetarët, posaçërisht për produktet efikase energjetike.

"70% e qytetarëve janë të vetëdijshëm se pajisjet që janë më efikase dhe ata mund të blejnë vetë ose investojnë më shumë në pajisje efikase energjetike në tregje. 68% e bizneseve kanë raportuar se kanë njohuri të nevojshme për tu ofruar klientëve informata për këto produkte."

- Zyrtari për efikasitet energjetik – Komuna e Drenasit.

Ngjashëm me këtë, Zyrtari i lartë për efikasitet energjetik dhe kogjenerim sqaroi se fushatat që kanë për qëllim të rrisin vetëdijen për përfitimet e masave të caktuara, janë pjesë e projekteve të tyre Fushata për efikasitet energjetik është nisur nga MEM për të informuar qytetarët për përfitimet afatgjate që ata do të kenë me rritjen e efikasitetit të energjisë dhe në shpenzimin e saj. Tutje, ai sugjeroi se përparimi i bashkëpunimit me qytetarët duke përdorur qasjen nga poshtë lartë, do të prodhojë rezultate të frytshme. Ky bashkëpunim mund të krijohet duke futur "Korporatën energjetike", - që është një nocion që përdoret kur një komunitet bëhet bashkë dhe vendosë për investime në burime ndryshe të energjisë, p.sh. në energji solare; dhe njëkohësisht duke inkurajuar komunitet tjerë të vogla të sillen në mënyrë të njëjtë. Sipas përfaqësuesit të MEM-it kjo është një praktikë e suksesshme që ka funksionuar në Bashkimin Evropian.

Promovimi i përfitimeve afatgjate të këtyre iniciativave, është një qasje që është marrë në shqyrtim edhe nga sektori i mobilitetit. Komuna e Prishtinës planifikon të organizojë fushata për transportin e qëndrueshëm, për të inkurajuar përdorimin e transportit publik dhe mjeteve tjera të qëndrueshme të udhëtimit. Për këtë, ofrimi i infrastrukturës së duhur për ciklizëm dhe ecje, do të shkojnë paralelisht me promovimin e përfitimeve shëndetësore që vijnë si rezultat i përdorimit të biçikletave dhe ecjes. Duke ju paraqitur qytetarëve iniciativë të duhura, që kanë përfitime shëndetësore, këto janë treguar si iniciativë të suksesshme dhe janë përshtatur nga Nju Jorku (New York) deri në Mbretërinë e Bashkuar. Fushata të ngjashme janë projektuar me planin e qëndrueshmërisë të komunës së Prizrenit, pasi që ato kanë ndërmarr veprime për ulur emetimin e gazrave serë.

5. Rekomandime për iniciativat qyteti i mençur në tëardhmen në Kosovë

Rezultatet e këtij studimi, përveç identifikimit të iniciativave të planifikuara dhe të zbatuara për qytetet e mençura në Kosovë, paraqesin po ashtu edhe sfida të ndryshme që ngadalësojnë përparimin dhe dizajnin e qyteteve të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Edhe pse janë bërë shumë tentime, Kosova ka një rrugë të gjatë përpara për të arritur tek agjenda Qyteti i Mençur. Çështjet si mungesa e financimit, mungesa e vizionit afatgjatë dhe strategjive, mungesa e personave adekuat për digjitalizim, mungesa e bashkëpunimit ndër komunal, paraqesin disa nga brengat që u identifikuan nga ky studim. Iniciativat dhe veprimet nga vendet tjera, ofrojnë mësim të vlefshme për Kosovën, se si të tejkalohen këto çështje. Si të tilla, seksioni në vijim paraqet rekomandimet bazuar në përparësitë e Kosovës dhe praktikatat nga vendet tjera.

5.1 Ofrimi i mbështetjes për qeveritë lokale

Qeveria duhet të ofroj mbështetje komunave për të zhvilluar kapacitete që mundësojnë investime në projektet qyteti i mençur. Anketa online me kryetarët e qyteteve, ka identifikuar buxhetin si njëra nga sfidat kryesore për zbatimin e iniciativave qyteti i mençur, pasuar nga mungesa e kapaciteteve të brendshme dhe mungesa e vizionit afatgjatë. Për këtë arsye, qeveria duhet të ofroj mbështetje kur janë në pyetje fondet dhe udhëzime për qeveritë lokale, për të ju ndihmuar në zhvillimin e vizionit dhe strategjisë që integrojnë teknologjitë digjitale në dizajnimin e qyteteve të tyre. Ky do të ishte hapi i parë drejt ndihmës së qyteteve në adresimin e sfidave për zhvillimin e zgjidhjeve që përmirësojnë jetën e qytetarëve të tyre.

5.2 Fuqizimi i bashkëpunimit ndër komunal

Rezultatet e studimit tregojnë se ka mungesë bashkëpunimi ndër komunal. Kjo është esenciale në adresimin e sfidave sociale dhe në dizajnimin e vendeve që u përgjigjen nevojave të qytetarëve. Përparimi i bashkëpunimit ndërmjet qyteteve, do të krijonte mundësi për identifikimin e çështjeve të përbashkëta si ndotja e ajrit, për shembull dhe do të shtynte ato të bashkëpunojnë në dizajnimin e zgjidhjeve digjitale që adresojnë këtë problem. Kjo do të arrihej me themelimin e rrjetit të qyteteve, një iniciativë që do të lidhte qytetet për të ndarë njohuritë dhe veprimet. Rezultatet e studimit treguan se mungesa e bashkëpunimit të tillë ka penguar përparimin e komunave drejt transformimit të komuniteteve të tyre në vende të mençura. Krijimi i këtij rrjeti, do të mundësonte qyteteve që të këmbejnë praktikata dhe të mësojnë nga veprimet e njëri tjetrit. P.sh. komunat tjera mund të mësojnë nga veprimet e ndërmarra nga komunat e Prishtinës dhe Prizrenit, për mobilitetin e qëndrueshëm dhe mjedisin dhe për zbatimin e iniciativave të ngjashme në komunat e tyre.

5.3 Caktimi i udhëheqësit në nivelin komunal dhe atë kombëtar

Se lidërsipin në nivel kombëtar është i rëndësishëm, këtë mund ta thonë tentimet e shumë qeverive qendrore për të krijuar role lidërsipin në qeveritë qendrore, që monitorojnë përparimin e qyteteve bazuar në agjendat e tyre. Australia, për shembull, ka caktuar një ministër për qytete dhe Mbretëria e Bashkuar ka emëruar ministrin e qyteteve dhe ka krijuar një grup parlamentar me përfaqësuesit e të gjitha partive (UK All Party Parliamentary Group, UAPP), që i bashkon të gjithë hisedarët nga institucionet e ndryshme, për të ndarë sfidat qyteti i mençur dhe për të gjetur zgjidhje për to. Një lidërsip i tillë nga niveli kombëtar, është i nevojshëm për të rreshtuar punën e të gjithë hisedarëve të përfshirë në ekosistemin qyteti i mençur dhe për të nxitur përparimin drejt qyteteve të mençura. Nevoja për një lidërsip të tillë është theksuar nga komunat e Kosovës pjesëmarrëse në studim.

Mirë po, vetëm lidërsipin në nivel kombëtar, nuk mjafton. Vetë qytetet duhet të kenë vizion dhe strategji për zbatimin e projekteve të tyre qyteti i mençur dhe të nxisin transformimin digjital. Ne rekomandojmë që qytetet duhet të krijojnë pika që ofrojnë udhëzim dhe mbështetje për zbatimin e strategjisë digjitale. Veprime të tilla janë ndërmarr nga qytetet si Nju Jorku për shembull, i cili ka krijuar pozitën e Zyrarit të lartë për digjitalizim për strategjinë digjitale të tyre. Vende tjera kanë krijuar pika për të siguruar se komunat kanë udhëzimet e nevojshme dhe këshillat, për teknologji dhe çështje të të dhënave.

Kjo do të siguronte se do të punohet në rreshtim me vizionin dhe strategjinë e zhvilluar për qytetin e tyre dhe do të lehtësonte bashkëpunimin ndërmjet departamenteve të ndryshme. Qeveritë kombëtare mund të luajnë një rol të rëndësishëm në inspirimin për veprime të tilla. Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar ka motivuar 30 komuna të punojnë në strategjitë e tyre qytetet e mençura, duke u ofruar atyre 50,000 £ për të zhvilluar strategjitë e tyre, me një shtesë prej 24 milion £ për zbatimin e saj.

5.4 Zhvillimi i vizionit dhe strategjive kombëtare qyteti i mençur

Ne rekomandojmë që Kosova të zhvilloj një vizion dhe strategji Qyteti i Mençur, e cila do të përfshinte sfidat me të cilat ballafaqohen qytetet dhe mundësitë e përfitimit që qytetet e mençura sjellin në çështjet e urbanizmit. Të pasurit e një vizioni qyteti i mençur, ku rezultatet dhe përfitimet janë të qarta, do të ndihmonte të merrej edhe përkushtimi i bizneseve, qeverive dhe të qytetarëve, për të mbështetur këto iniciativa. Pastaj, një strategji e qartë, do të hedhë dritë në veprimet që duhet të merren drejt arritjes së rezultateve.

5.5 Transformimi digjital i shërbimeve publike

Vështirësitë me të cilat ballafaqohet Kosova në dizajnimin e qyteteve të mençura, nuk janë unike. Kjo ofron një mundësi të mirë për të parë se si qeveritë e vendeve tjera i kanë tejkaluar sfidat e rritjes së qytetit të mençur. Tashmë Kosova ka ndërmarrë veprime në drejtim të transformimit digjital të shërbimeve publike të saja. Mirë po, i duhet që të sigurohet se këto shërbime janë të qasshme dhe u japin përgjigje nevojave të qytetarëve. Shërbimi digjital i qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, është një mësim i vlefshëm që Kosova duhet ta mësoj deri sa punon në transformimin digjital të shërbimeve publike. Ata kanë krijuar një platformë që u përgjigjet nevojave të përdoruesve e jo nevojave të qeverisë. Kjo u bë e mundur pas zhvillimit të parimeve që do të udhëzonin krijimin e një vebfaqeje të vetme për qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar, bazuar në qasjen përdoruesi është në qendër të vëmendjes. Kosova ka një mundësi të mirë të integroj të gjitha shërbimet publike në një vend të vetëm. Dizajnimi i platformës të bazuar në të qenit e lehtë për përdorim, do të rezultonte në pjesëmarrje të rritur të qytetarëve dhe do të nxiste transformimin digjital të qyteteve të Kosovës.

5.6 Inkurajimi i hisedarëve të përfshirë të përdorin open data

Vërja e të dhënave në dispozicion online, është hapi i parë drejt përfitimit nga to. Hapi tjetër është inkurajimi i qytetarëve dhe bizneseve ti përdorin ato. Kosova ka ndërmarr hapa drejt vënies së të dhënave në dispozicion të publikut, duke ofruar qasje në grup të të dhënave nga sektorët e ndryshëm. Platformat, prej atyre që raportojnë brengat e qytetarëve deri tek ato që ofrojnë informata për qytetarët për shpenzimet publike, tashmë janë krijuar. Mirë po, për të krijuar Kosova një kulturë të Open Data dhe të përdorimit të të dhënave për krijimin e zgjidhjeve qyteti i mençur, është kruciale të përfshihen hisedarë të ndryshëm, nga shkencëtarët e të dhënave deri tek dizajnerët e planifikimit urban dhe novatorët. Është me rëndësi të veçantë që qeveria tu ofroj bizneseve dhe novatorëve infrastrukturën relevante të të dhënave, deri sa ata punojnë në mjete inventive. Një mundësi do të ishte themelimi i Institutit Open Data, që do të bashkonte institucionet qeveritare dhe bizneset deri sa ata punojnë në zhvillimin e standardeve teknike dhe veçoritë për integrimin e zgjidhjeve digjitale.

Kosova mund të ndjekë veprimet e qyteteve për të dhëna të hapura dhe për të krijuar vlerë të domethënëse nga to. London Data Store është njëri nga liderët në vënien e të dhënave publike në dispozicion dhe ndihmën që është në funksion të qyteti. Qëllimi i tyre është ti bëjnë ato lehtë të kuptueshme për qytetarët dhe për të krijuar mundësi për bizneset për ti përdorur ato dhe për të krijuar zgjidhje qyteti i mençur. Ndarja dhe grumbullimi i të dhënave nga sektorë të ndryshëm, ndihmon që të shihet pamja e madhe dhe kjo rezulton në një proces më efikas të marrjes së vendimeve. Hapja e të dhënave për përdorim nga publiku, ka dhënë rezultate domethënëse në Mbretërinë e Bashkuar. Ekonomia digjitale ka parë një rritje të shpejtë me më shumë se 460 aplikacione të zhvilluara nga baza e të dhënave e Londrës. Kjo thekson mundësitë dhe përfitimet me rastin e përdorimit të të dhënave për të krijuar vlera në Kosovë.

5.7 Arsimi dhe trajnimi i shoqërisë civile

Për fund, Kosova ka nevojë të kuptoj se shoqëria civile, janë aktorë e jo vetëm pjesëmarrës në këto zgjidhje digjitale. Informatat kthyesë të tyre, janë esenciale për identifikimin e sfidave dhe dizajnin e qyteteve gjithëpërfshirëse, që përmirësojnë kualitetin e jetës. Hapi i parë drejt bërjes së qytetarëve pjesë e këtij transformimit, është të sigurohet popullata e Kosovës do të ketë qasje në infrastrukturën digjitale dhe arsim. Me fjalë tjera, komunitat duhet të sigurojnë që qytetarët kanë qasje në përfitimet e digjitalizimit. Që kjo të ndodhë, të gjitha qytetarët duhet të mësohen me teknologji digjitale dhe të përshtaten me shërbimet e reja publike që digjitalizimi i ka transformuar. Tutje, duhet të ofrohet trajnim në vend të punës për të punësuarit në institucionet komunale, për të siguruar se ata janë të gatshëm të përshtaten ndaj provizioneve të shërbimeve të transformuara, që digjitalizimi i ka bërë. COVID 19 ka qenë një përkujtues për të ndërmarr veprime në këtë drejtim, pasi që shumë njerëzve i është kërkuar të punojnë nga shtëpia, pa njohuri të duhura për teknologjitë digjitale. Kjo do të qonte përpara pjesëmarrjen e shoqërisë civile në platforma digjitale dhe do të mundësonte bërjen e politikave, duke qenë pjesë e ekosistemit qyteti i mençur.

Në Danimarkë, përveç qeverisë, organizatat e shoqërisë civile kanë luajtur një rol në edukimin digjital të shoqërisë. Qeveria e Danimarkës në anën tjetër, ka stimuluar këto iniciativa duke dhënë shpërblime për organizatat që kanë kontribuar në edukimin për teknologji dhe njohuri të shoqërisë civile.

Mund të jemi të bindur se, me një vizion, strategji afatgjate dhe qeverisje efektive, Kosova ka potencial të zhvilloj zgjidhje digjitale që përdorin teknologjinë e informacionit dhe komunikimit për një përdorim efikas të burimeve. Në themel të kësaj strategjie duhet të jetë bashkëpunimi ndërmjet institucioneve publike nga niveli qendrorë dhe ai lokal, kompanive, asociacioneve, shoqërisë civile dhe hisedarëve tjerë relevant, që janë pjesë e ekosistemit qyteti i mençur. Shembujt nga vendet e botës kanë dëshmuar rëndësinë e pjesëmarrjes publike për të shtyrë këto zgjidhje në veprim. Prandaj, një fokus i posaçëm duhet të vihet në programet edukative dhe në iniciativa që rrisin vetëdijen në popullatë dhe i edukojnë atë që të përshtatën lehtë këtyre zgjidhjeve teknologjike dhe që inkurajojnë ndryshim të sjelljes.







**FRIEDRICH NAUMANN
FOUNDATION** For Freedom.

Western Balkans